

KOSOVA **PËRBALLË SFIDAVE TË** **EMIGRIMIT**

TRENDI, PASOJAT
DHE RRUGËT E
ZGJIDHJES



Autor: Dr. Sc. Sami Behrami

Kontribues: Dardan Abazi

Programi: Zhvillim i Qëndrueshëm

Publikuar: Tetor, 2023



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.



**Rockefeller
Brothers Fund**
Philanthropy for an Interdependent World

Kjo përmbledhje politikash është publikuar me mbështetjen e Fondit të Vëllezërve Rockefeller (RBF). Mendimet dhe pikëpamjet e autorëve nuk shprehin ose pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të RBF.

Përmbajtja

HYRJE.....	3
EMIGRIMET E POPULLSISË	5
SHKAQET E EMIGRIMEVE.....	9
DISA PROBLEME RRETH STATISTIKAVE TË EMIGRIMEVE.....	10
EMIGRIMET E BRENDSHME - KOMBËTARE TË POPULLSISË.....	12
Trendet e emigrimeve të brendshme	12
Balanci i emigrimeve të brendshme sipas komunave	14
EMIGRIMET E JASHTME - NDËRKOMBËTARE TË POPULLSISË	15
Trendet e emigrimeve të jashtme të popullsisë 2011-2021.....	15
Emigrimet e jashtme nga Kosova sipas komunave.....	18
SFIDAT KRYESORE	22
Sidat e emigrimeve të brendshme.....	22
Sidat e emigrimeve të jashtme	23
PASOJAT NGA EMIGRIMET.....	25
Pasojat demografike	25
Pasojat socio - ekonomike	28
Pasojat në sistemin arsimor	30
Pasojat për sigurinë e vendit	33
MASAT KUNDËR EMIGRIMIT.....	35
PËRFUNDIM	37
REKOMANDIME.....	40

HYRJE

Kosova sot ndodhet para ndryshimeve radikale në profilin e saj demografik: në njërin anë kemi zvogëlim drastik të numrit të lindjeve - shtimit natyror, ndërsa në anën tjetër si pasojë e emigrimeve selective, popullsia po plaket me trend të përshpejtuar. Situata është aq e pafavorshme sa mund të përcaktohet edhe si krizë demografike. Krize demografike me të cilën po përballet Kosova sot, në dekadat e ardhshme do të thellohet edhe më tepër prandaj me qëllim të zvogëlimin të pasojave është e domosdoshme ndermarrja dhe zbatimin e masave dhe politikave të mirëfillta. Meqenëse emigrimet janë faktori më i rëndësishëm në rënien ose stagnimin e popullsisë së Kosovës, është e nevojshme që shteti të veprojë në mënyrë që të ndikoj në zvogëlimin e shkaqeve që nxisin emigracionin. Krijimi i kushteve për njerëzit, e sidomos për rininë që të kontribuoj në ndërtimin e një të ardhme në vendin e tyre, është çelësi për ndalimin e emigrimeve dhe zgjidhjes së krizës demografike në Kosovë. Nëse shkaqet që nxisin popullsinë për emigrim nuk adresohen, masat tjera të orientuara në rritjen e natalitetit thjesht mund të rezultojë në ikjen e më shumë njerëzve nga vendi.

Zhvillimet demografike dhe pasojat e këtyre zhvillimeve si ato të tashme, ashtu edhe ato me të cilat do të përballet shoqëria kosovare në të ardhmen, nuk lejojnë mbajtjen e një qëndrimi indiferent kundrejt shoqërisë dhe shtetit. Marrja e masave të menjëhershme të politikave popullore me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm demografik i cili është kusht për zhvillim të qëndrueshëm të përgjithshëm dhe plotësimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm, është më së e nevojshme.

Fatkeqësisht, si pasojë e mungesës së politikave të mirëfillta për migracion si dhe për diasporën, edhe anët pozitive të emigrimeve (remitancat, njohurit e fituara nga emigrantet, investimet etj.) Kosova nuk është duke i shfrytëzuar për zhvillim. Me qëllim të përmirimit të gjendjes, Kosova duhet të ndryshoj shumëçka: që nga politikat dhe strategjitë ekzistuese, deri tek çësja ndaj diaspores duke u orientuar në modelin 3T, që nënkupton tri tipe të transferimeve:

- Transferimi i kapitalit social - rrjetet e emigrantëve;
- Transferimi i njohurive- ekspertiza dhe
- Transferimi i burimeve financiare - remitancat të cilat kanë dimension zhvillimor duke i kthyer emigrantët në element shumë të rëndësishëm të ndryshimit, gjegjësisht potencial zhvillimor¹.

Me qëllim të shmangjes së pasojave që sjellin emigrimet për zhvillimin e përgjithshëm demografik, socio-ekonomik, politik, sigurisë etj., Kosova pikënisje duhet të ketë shfrytëzimin racional të të gjitha resurseve duke përfshirë në radhë të parë resurset njerzore dhe valorizimin e tyre, si dhe pengimin e shpërndarjes- emigrimit të mëtejshëm të tij sikur trendet e dekadës së fundit.

¹ Behrami S., (2022). “Emigrimet e popullsisë- një mundësi e pashfrytëzuar për zhvillim lokal në Kosovë”. Instituti për Politika Zhvillimore- INDEP, Prishtinë. fq. 10. E qashme në : <https://indep.info/emigrimet-e-popullsisë-një-mundësi-e-pashfrytëzuar-per-zhvillim-lokal-ne-kosove/>

Qëllimi i studimit është njohja me trendet, shkaqet, pasoja dhe rrugë zgjedhjet e situates me emigrimet e popullsis në Kosovë, me theks të vecantë ne emigrimet e jashtme të dekadës së fundit, periudh në të cilën Kosova është ballafaquar me fluks shumë të lartë të emigrimeve sidomos atyre jasht vendit. Studimi gjithashtu është një përpjekje për të përcaktuar ndikimit dhe pasojat e trendi aktual të emigracionit në zhvillimet demografike, socio-ekonomike dhe te siguris në Kosovë duke u bazuar në statistikat në dispozicion të publikut. Gjithashtu, studimi shërben si hap në krijimin e një bazë për analiza më të thella dhe më të hollësishme për ndikimin e emigrimeve në secilin sektor veç e veç që do të mundë të jenë objekt trajtimi në studimet në të ardhmen.

Gjendja e tanishme me emigrimet në Kosovë kërkon ndërmarrjen e masave të menjëhershme të politikave popullatave me qëllim që emigrimet të jenë të qëndrueshme që nënkupton që emigrimet e popullsis të mos shndërrohen në pengës për zhvillimin e përgjithshem në Kosovë.

Të dhënat e këtij studimi mundë të jenë udhërrëfyes për kreatoret e politikës me rastin e përgatitjeve të strategjive sektoriale dhe nder sektoriale me qëllim të shmangies nga zhvillimet e pa favorshme të shkaktuara nga trendi i till i emigrimeve të cilat do të jenë pengës në rrugëtimin e Kosovës drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Studimi përbehet prej nëntë kapitujve dhe përmbillet me perfundime dhe rekomandime për hapat të cilet duhet ndermarr me qëllim që emigrimet të jenë të qëndrueshme dhe në funksion të zhvillimit të Kosovës, duke i shëndrruar emigrimet në këtë rrugëtim në partnere dhe pasuri, e jo në humbje edhe kërcënim.

EMIGRIMET E POPULLSISË

Në të gjithë botën lëvizja e popullsisë është karakteristike për shoqërinë prej shumë kohësh. Gjatë gjithë historisë së zhvillimit, lëvizjet migruese ishin të nxitura nga një varg faktorësh ekonomik, social dhe politik, të cilat ishin të kushtëzuara dhe lidhura në kohë dhe hapësira të caktuara. Lidhjet pozitive në mes nivelit të zhvillimit ekonomik (si varfëria, problemet ekonomike, papunësia, etj.), në njërin anë dhe lëvizjeve migruese të popullsisë në anën tjetër, tregojnë se faktorët ekonomik janë kryesorët, por jo të vetmit të cilët ndikojnë në lëvizjet migruese duke i shndërruar migrimet në një proces kompleks.

Migrimet mund të ndahen në bazë të disa kriterëve si:

1. Hapësirës që përfshin: Të brendshme (brenda shtetit) dhe të jashtme (në mes shteteve);
2. Kohës së përfshirjes: Ditore, javore, mujore, sezonale, përkohshme dhe përhershme;
3. Motivit ose shkaqeve: Ekonomike dhe joekonomike;
4. Vullnetit: Vullnetare ose të dhunshme;
5. Organizimit: Organizuar dhe të paorganizuar (stihike).

Lëvizja e popullsisë përfshin vendin e prejardhjes (vendin e mëparshëm të banimit) dhe vendin e ardhjes, prandaj për këtë arsye migrantet ndahen në emigrant (shkuarje) dhe imigrant (ardhje). Të gjitha llojet e migrameve kanë efekte të dyfishta, së pari në vendin e prejardhjes dhe së dyti në vendin e ardhjes, me ndikim në ndryshimin e popullsisë së përgjithshme, shpërndarjen e strukturave të popullsisë, zhvillimin ekonomik etj.

Si fenomen shoqëror, migrimet e popullsisë për shkak të masivitetit në ditët e sotme, mund të konsiderohen si procese botërore bazuar në evidenca dhe statistika. Nga ky proces, sipas statistikave të OKB-së nga viti 2020 (The World Migration Report, 2022), në forma të ndryshme janë përfshirë me tepër se 1 miliardë banorë, prej të cilëve 281 milion (ose 3.6% të popullsisë së përgjithshme të planetit) i takojnë grupit të migrameve ndërkombëtare. Nga këta numra, afërsisht gjysma janë gra me moshë mesatare 39 vjet, 15 % i takon grupmoshave deri 19 vjet, 73 % i takojnë grupmoshave 20 deri 64 vjet. 4 nga 10 emigrantë jetojnë në vendet në zhvillim dhe rreth 62% i takojnë emigrantëve ekonomik.

Mungesa e stabilitetit politik dhe dallimet në nivelin e zhvillimit ekonomik në mes të shteteve janë faktorë të rëndësishëm në rritjen e fluksit të migrameve politike dhe ekonomike. Kështu, gjatë periudhës 1990 – 2000, numri i migrameve ndërkombëtare është rritur për rreth 21 milion, për të vazhduar me këtë tendencë të rritjes në periudhën 2001 - 2010 me rreth 46.2 milion, ndërsa vetëm

gjatë viteve 2011 – 2020 ky numër u rrit edhe për 60.5 milion emigrantë². Nga numri i përgjithshëm i emigrimeve ndërkombëtare mbi 60% vijnë nga vendet në zhvillim.

Emigrimi i popullsisë nga Kosova në vendet evropiane nuk është fenomen i ri. Kosova gjatë gjithë shekullit XX dhe fillimin e shekullit XXI ishte dhe mbeti territor tipik emigrues. Shkaktarët kryesor të cilët detyruan popullsinë të emigrojë ishin dhe vazhdon të mbetet: niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, shkatërrimet nga luftërat, situata jo e favorshme politike, ndërtimi i sistemit bazuar në kritere partiake dhe nepotizëm duke mënjanuar meritokracinë dhe vlerat në ndërtimin e sistemit, pakënaqësia e qytetarëve të Kosovës për perspektivën e së ardhmes socio-ekonomike dhe me nivelin e përgjithshëm të mirëqenies, e cila manifestohet me shkallë të lartë të papunësisë (sidomos në mesin e të rinjve) dhe përqindje të lartë të njerëzve që jetojnë në varfëri etj. Andaj, çështjet ekonomike që lidhen me papunësinë dhe varfërinë janë shqetësimet kryesore të qytetarëve të Kosovës. Hulumtimet e fundit të opinionit tregojnë se këto dy parametra ekonomik janë edhe kërcënime të sigurisë kombëtare me të cilat përballlet Kosova. Sipas këtyre të dhënave rreth 70% e të anketuarve besonin se shkalla e lartë e papunësisë është kërcënimi më i madh për Kosovën³. Marrë parasysh shkallën e lartë të papunësisë dhe numrin e madh të njerëzve që jetojnë nën nivelin e varfërisë, emigrimi shihet si mundësi nga qytetarët e Kosovës për të gjetur një perspektivë më të mirë shoqërore dhe ekonomike jashtë vendit, duke i shndërruar emigrimet në rrezik për zhvillimet demografike, socio- ekonomike dhe të sigurisë në vend.

Edhe pse ekzistonte bindja se me lirinë dhe pavarësinë e Kosovës do të zbuteshin flukset e emigrantëve, trendi i migracionit fatkeqësisht vazhdon të jetë i përmasave shqetësuese edhe pas periudhës së luftës së vitit 1999. Sipas statistikave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, vetëm në periudhën 2000-2021 Kosovën e kanë braktisur mbi 420 mijë banorë (sipas statistikave të ASK), me mesatare prej mbi 21 mijë banorë brenda vitit. Kontingjenti i emigrantëve pa dyshim që është edhe më i madh sesa këta numra, kur dihet fakti i emigrimeve ilegale të kosovarëve dhe emigrimi me pasaporta të vendeve tjera.

Kosovarët, nga kërcënimet politike të fundshekullit, tani ndjenin kërcënimin ekonomik. Menaxhimi i keq i procesit të privatizimit, shpërdorimi i parasë publike, korrupsioni, nepotizmi etj. jo vetëm që e zbehën perspektivën dhe e shtuan dëshpërimin në shtetin më të ri me popullatën më të re në Evropë, por e shtuan nevojën e ikjes nga Kosova e lirë, e që kërcënon me agonalitet. Kur gjithë kësaj i shtohet fakti se në Kosovë vazhdojnë të mungojnë investimet e pritshme të jashtme (kryesisht për shkak të resurseve dhe fuqisë së re punëtore nga trajtimi i Kosovës si terren i pasigurt politik për shkak të gjendjes së rëndë në Veriun e Kosovës) dhe mungesës së përkrahjes së bashkësisë ndërkombëtare përtej fazës së emergjencë, sidomos në rivitalizimin e potencialeve dhe asetëve ekonomike kombëtare, izolimin nga bota me mosliberalizimin e vizave etj. krijuan një gjendje e cila për shumë individë dhe

² “International Migration 2020- Report”, Departamenti i Marrëdhënieve Ekonomike dhe Sociale-Divisioni i Popullsisë, Kombet e Bashkuara, New York, 2022, fq 3-10.

https://www.un.org/en/development/desa/population/migration/publications/migrationreport/docs/InternationalMigration2020_Report.pdf

³ Behrami S. (2019). “Emigrimet! A po rrezikohet Kosova nga ky fenomen?”. Kosova Sot. E qasshme në: <https://www.kosova-sot.info/opinione/431875/emigrimet-a-po-rrezikohet-kosova-nga-ky-fenomen/>

familje u përjetua si e pashpresë⁴. Akoma më shqetësuese është fakti se, bazuar në sondazhe të ndryshme të realizuara në vend, mbi 60% e të anketuarve kanë shprehur dëshirën të ikin nga Kosova prej të cilëve kryesisht përfaqësojnë gjeneratën e re (20 deri në 40 vjeç), të cilët përbëjnë kontingjentin kryesor demografik dhe të lindshmërisë, kontingjentin e punës, të sigurisë, etj., duke shkaktuar rënie të kapitalit njerëzor si bartësin kryesor të zhvillimit socio-ekonomik.

Migrimi i popullsisë do të jetë tipi përcaktues i zhvillimeve demografike të shekullit XXI, të cilat kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në të gjitha aspektet e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. Si të tilla, do të jenë thelbësor për arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm. Agjenda 2030 për zhvillim të qëndrueshëm në mënyrë të veçantë thekson kontributin e migracionit për ekonominë dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Agjenda 2030 si dokumenti më i rëndësishëm i tri dekadave të para të shek. XXI, migrimet e popullsisë (sidomos ato ndërkombëtare) i trajton si mundësi të madhe për zhvillimin e përgjithshëm të vendeve të origjinës, transitit dhe destinacionit drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Megjithatë, vetëm nëse ato menaxhohen dhe përcillen me masa e politika të mirëfillta të cilat në Kosovë fatkeqësisht mungojnë, dhe kanë ndikuar që përveç remitencave, efektet pozitive të migrameve në sferën e zhvillimit në Kosovë të jenë minimale, kurse efektet negative të jenë shumë më të mëdha duke filluar nga zhvillimet demografike, socio-ekonomike dhe të sigurisë në vend⁵.

Me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të emigrantëve, në vitin 2013 është hartuar agjenda tetë pikëshe e cila i bën thirrje komunitetit ndërkombëtar që të përmirësojë nivelin e mbrojtjes së të drejtave për të gjithë emigrantët, të ulë kostot e migracionit, t'i jepet fund shfrytëzimit të emigrantëve, të trajtohet gjendja e emigrantëve në vështirësi, të përmirësojë perceptimin publik të emigrantëve, të integrojë migracionin në agjendat zhvillimore me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm, të fuqizojë bazën e dëshmive të migrimit dhe të thellojë partneritetet dhe bashkëpunime rreth migrimit.

Temë trajtimi i këtij studimi do të jenë emigrimet e popullsisë në kontekstin e hapësirës që përfshin emigrimet:

- Të brendshme (brenda shtetit) dhe me theks të veçantë
- Të jashtme (ndërmjet shteteve);

Emigrimi kombëtar (i brendshëm), tregon largimin e popullsisë nga një vendbanim në një vendbanim tjetër (komunë, regjion) por brenda kufijve kombëtarë, ndërsa emigrimi i jashtëm (në mes shteteve) tregon largimin e popullsisë nga vendi i tij/saj i lindjes në një shtet tjetër pa marrë parasysh nëse ai / ajo ka ndonjë status të veçantë në vendin në të cilin ka emigruar.

Për sa i përket politikës së emigrimit, ka dy qasje konfliktuale të politikbërësve edhe jo vetëm: nga njëra anë, diaspora konsiderohet partnere dhe pasuri, ndërsa në anën tjetër humbje e madje edhe

⁴ Berishaj A. (2018). "Fjalë hyrëse në tryzën për migrimet". Studime Shoqërore 4. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Seksioni i Shkencave Shoqërore. Prishtinë. fq 29-30. E qasshme: <https://ashak.org/botime/studime-shoqerore-4/>

⁵ Behrami S., Bajraktar F. (2021). "Dimensioni Demografik i Agjendës 2030 - Perspektivat dhe Sfidat e Kosovës". Faqe 32-33. Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP. Prishtinë. E qasshme në: https://indep.info/wpcontent/uploads/2021/07/INDEP_Dimensioni-i-Demografikes-se-Agjendes-2030_14072021.pdf

kërcënim⁶. Nga qasja dhe këndvështrimi i shtetit ndaj diasporës me politika të caktuara të fokusuara në heqjen e pengesave dhe krijimin e mundësive (duke e bërë më të lehtë për anëtarët e diasporës që të angazhohen në aktivitetet ekonomikisht produktive), në masë të madhe varet nëse emigrimet dhe diaspora do të jetë pasuri dhe partnere ose humbje dhe kërcënim.

Në Kosovë si pasojë e mungesës së politikave të mirëfillta ndaj diasporës, sot për sot, emigrimet dhe diaspora, më tepër mund të si konsiderohen humbje dhe kërcënim, se sa pasuri dhe partner edhe pse në realitet diaspora është pasuri shumë e çmuar në themelimin e vet shtetit të Kosovës.

Studimi analizon emigrimin e popullsisë së Kosovës me theks të vecantë në dhjetë vitet e fundit bazuar në analizën e të dhënave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK). Statistikat për zhvillimet të ardhshme demografike janë të bazuara në variantin mesatar i cili do të reflektoj prirjet e ardhshme demografike që ASK i vlerëson si me gjasë të mundshme, bazuar në të dhënat aktuale që janë dhënë si dhe njohuritë lidhur me gjendjen dhe trendët demografike në vend⁷.

Megjithatë zhvillimet demografike të periudhës pas përgatitjes së Parashikimit të Popullsisë, sidomos trendi i lartë i emigrimeve dhe ulja e shpejtë e shtimit natyror sipas mendimit tonë, më tepër favorizojnë prirjet e variantit të ulët në zhvillimet.

⁶ Newland K, and Plaza S. (2013): “What we know about diasporas and economic development”. Migration Policy Institute Policy Brief No. 5.

⁷ “Parashikimi i popullsisë së Kosovës 2017-2061” (2017). Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Prishtinë. fq. 10. E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/media/6288/parashikimi-i-popullsis%C3%AB-2017-2061.pdf>.

SHKAQET E EMIGRIMEVE

Shkaqet e emigrimeve të kosovarëve janë nga më të ndryshmet të cilat varen nga periudha të cilës i takojnë. Kështu emigrimet- shpërnguljet për në Turqi të periudhës 1912-1965 që për qëllim kishin spastrimin etnik të Kosovës realizoheshin nën dhunën dhe terrorin e pushteteve të përcjellura me procesin e kolonizimit me element sllav. Të gjitha këto emigrime kishin karakter politik.

Nga gjysma e dytë e viteve të '60 të shek. XX, emigrimet ishin të orientuara drejt vendeve të Evropës Përqendrore dhe më tepër kishin karakter ekonomik. Ngecja e Kosovës në zhvillim ekonomik ishte faktori kryesor shtytës i emigrimeve drejt vendeve evropiane. Në të njëjtën kohë kjo është periudha më stabile sa i përket emigrimeve.

Emigrimet e viteve të '90 të cilat kishin karakterin e eksodit masiv ishin të orientuar drejt të gjitha vendeve të Evropës së mesme dhe perëndimore, posaçërisht në drejtim të Gjermanisë, Zvicrës, Austrisë, vendeve Skandinave etj., ishin të karakterit ekonomik dhe politik.

Emigrimet e dy dekadave shek. XXI si motiv kryesor kanë nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik, varfërinë e përhapur, papunësisë së lartë, korrupsionit dhe mungesën e perspektivës për të ardhmen dhe emigrimin për qëllim të bashkimit familjar.

Në përgjithësi arsytet kryesore të emigrimeve të popullsisë së Kosovës kanë qenë: arsytet politike të cilat u takojnë periudhave 1912-1965, politike- ekonomike 1990-1999 dhe arsytet ekonomike dhe sociale të cilat u takojnë periudhës 1966-1989 dhe 2000- 2021. ***Në dekadën e fundit përveç arsyeve ekonomik të emigrimit, humbja e shpresës dhe pasigurtë për të ardhmen më të mirë në Kosovë është kthyer në arsytet kryesore për emigrim.***

Bazuar në statistikat e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës - Migrimi Kosovar në të cilin janë trajtuar vetëm emigrimet pas viteve të '60 të shek. XX, arsyejet kryesore të largimit nga Kosova janë: 45.7% janë familjare, 35.4% punësimi, 7.6% lufta 1998/99 dhe rreth 10% arsyeje tjera. Vetëm 1.1 % e emigranteve si shkak për emigrim kanë deklaruar studimin.

Edhe në periudhën pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës arsytet e emigrimit nuk ndryshojnë shumë përveç se kemi një rritje të arsyeve familjare në 48.8% dhe atyre ekonomike në 37.9%, e që janë të kuptueshme kur dihen parasysh faktet e emigrimeve masive të viteve të '90 dhe gjendja e rënduar ekonomike dhe shkalla e lartë e papunësisë sidomos të të rinjtë në Kosovë.

Mirëpo nëse marrim për bazë numrin e përgjithshëm të popullsisë së emigruar gjatë gjithë shekullit XX dhe dy dekadat e shek. XXI, atëherë mund të konstatojmë se arsyeje kryesore të emigrimit të kosovarëve janë të karakterit politik dhe politiko-ekonomik⁸.

⁸ Sami Behrami, Fadil Bajraktari, Nazmi Zogaj (2019) "Emigrimet nga Kosova gjatë shekullit XX dhe fillimin e shek. XXI". Studime Gjeografike, FHF, Universiteti i Tiranës, Tiranë fq 27-49.

DISA PROBLEME RRETH STATISTIKAVE TË EMIGRIMEVE

Para se të kalohet në elaborimin e zhvillimeve migruese e shohim të arsyeshme për sqarimin e disa probleme të cilat lidhen me statistikat e migrimeve jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë. Për kundër peshës dhe rëndësisë në rritje të emigrimeve, statistikat e lëvizjes hapësinore të popullsisë janë të kufizuara dhe të mangëta krahasuar me statistikat tjera të popullsisë, konkretisht me statistikat vitale. Kufizimet dhe mangësitë e statistikave të emigrimeve posaçërisht janë të shprehura me rastin e emigrimeve të jashtme.

Në Kosovë, me rastin e hulumtimit të proceseve të ndryshme demografike (posaçërisht i migrimeve) për periudha afatgjate, paraqitet një numër i konsiderueshëm i vështirësive metodologjike. Në radhë të parë çështja me numrin e personave të shpërngulur- zhvendosur për një periudhë të gjatë, e vështirëson përgjigjen e saktë të problemin, si pasojë e mungesës dhe cilësisë së statistikave mbi migrimet e popullsisë.

Në Kosovë ky është problem bëhet edhe më shqetësues për faktin se statistikat demografike shpeshherë janë shfrytëzuar për qëllime politike, ndërsa për shpërnguljet- emigrimet gjatë periudhave të ndryshme, botimi i statistikave ishte edhe i ndaluar, meqenëse në luftën demografike të Serbisë për Kosovën përveç vrasjeve, shpërnguljen e shqiptarëve, kolonizimi i propagandës kundër lindshmërisë dhe shtimit natyror etj., një fushë speciale e luftës ishte edhe statistikat e falsifikuara dhe të manipuluar sidomos në rastin e shqiptarëve. Prandaj, në rastin e hulumtimit të migrimeve sidomos të periudhave të mëhershme kemi të bëjmë kryesisht me vlerësime dhe shënime të mangëta historike për procesin. Burimi kryesor i statistikave të migrimeve e me këtë rast edhe emigrimeve të brendshme dhe të jashtme në Kosovë është regjistrimi i popullsisë. Gjithashtu, një nga problemet me të cilin studiuesit ballafaqohen në rast të analizimit të statistikave të migrimeve janë edhe statistikat e mangëta për vite të ndryshme, si dhe të dhëna të ndryshme për fenomenin e migrimeve edhe për vite të njëjta mes institucioneve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

Në aspektin metodologjik, studimi bazohet në analizën e të dhënave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, d.m.th. në bazë të statistikave zyrtare të cilat publikohen për migrimin kombëtarë e ndërkombëtar të popullsisë së Republikës së Kosovës, pasi që Kosovës i mungon regjistri i banorëve i cili do të ishte burim primar ku do të mund të shfrytëzoheshin statistikat për popullsinë në përgjithësi duke përfshirë edhe statistikat e migrimeve.

Me qëllim të permirsimit të statistikave të migrimeve, është jo vetëm e nevojshme por edhe e domosdoshme të mblidhen dhe analizohen të dhënat për shtetasit e Kosovës që punojnë ose qëndrojnë jashtë vendit, sepse kjo do të mundësonte:

- Kuptimin më të mirë të tendencave të tashme të emigracionit duke përfshirë: shtrirjen, tipologjin, shkaqet si dhe parashikimin më të mirë të flukseve të ardhshme të migracionit;

- Të dhënat cilësore dhe analizimi shkencor i proceseve të migracionit do të ndihmonte në kuptim më të plotë të implikimeve të emigrimeve në sferen demografike, sociale, ekonomike dhe politike të tendencave aktuale të emigracionit nga Kosova, që është një parakusht për reagim politik me krijimin e politikave dhe startegji të suksesshëm ndaj ndryshimeve në fushën e migracionit bashkëkohor;
- Ekzistojnë probleme të shumëta metodologjike lidhur me mbledhjen dhe regjistrimin e të dhënave sidomos për emigrimin e jashtëm, prandaj është e nevojshme bashkpunimi dhe krahasimi me të dhënat për numrin e emigrantëve në destinacionet përfundimtare edhe me organizatat e specializuara ndërkombtare;
- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Ministria e Punëve të Brendshme – Sektori për Emigracionin, në bashkëpunim me agjencitë dhe institucionet e tjera (ASK), mund të luajë një rol të rëndësishëm në iniciimin e një debati në lidhje me monitorimin statistikor të migracionit edhe në kontekstin e zhvillimit.

EMIGRIMET E BRENDSHME - KOMBËTARE TË POPULLSISË

Trendet e emigrimeve të brendshme

Në kuadër të emigrimeve të brendshme të popullsisë, emigrimet fshat-qytet pa dyshim si për nga vëllimi, intensiteti, shkaqet dhe pasojat paraqesin lëvizjet më komplekse si nga aspekti hapsinor ashtu edhe ai social. Braktisja e fshatit dhe e bujqësisë dhe kalimi në qytet dhe veprimtaritë jobujqësore bëhet kryesisht përmes dy formave:

- Forma e parë nxitej nga motive të natyrës ekonomike e shoqërore, para së gjithash nga kushtet më të rënda të jetës dhe punës, mungesa e rrugëve dhe e rrymës elektrike deri në vitet e 80-ta, e institucioneve të tjera të standardit shoqërore dhe infrastrukturës, por edhe nevoja dhe dëshira për të jetuar në qytet për të shkolluar fëmijët, pastaj përmes migrimit të martesave etj
- Forma e dytë zhvillohet nga deagrarizimi indirekt, përmes të punësuarve në qytet (fshatarët punëtorë, migruesit ditor e javor, migruesit sezonal e të jashtëm), si dhe shkollimit të rinjëve të cilët gradualisht duke u ndarë nga bujqësia e braktisin edhe fshatin dhe kalojnë në vendbanime urbane, ku punësohen në veprimtaritë jobujqësore⁹.

Në Kosovë veç një kohë të gjatë është aktual polarizimi demografik në viset atraktive (populluara) dhe jo atraktive (depopullative). Ky polarizim pas luftës së vitit 1999, ka marr dimensione shqetësuese të cilat vërtetohen edhe nga regjistrimi i popullsisë i vitit 2011. Historikisht zhvillimi rural ishte më i ngadalshëm në krahasim me atë urban, kështu që lëvizjet migruese fshat- qytet janë dominuese ndaj të gjitha lëvizjeve tjera migruese duke shkaktuar kështu mbipopullim në zonat urbane dhe zbrazje të zonave rurale edhe pse këto zona ofrojnë kushte të përshtatshme për zhvillimin e shumë veprimtarive ekonomike, e jo vetëm të bujqësisë siç ishte praktikë në të kaluarën. Zhvillimi industrial është i koncentruar kryesisht në zonat urbane që si rezultat kishte emigrimet e popullsisë (bujqësore) rurale e cila ka dhe do të ketë impakte afatgjate dhe pasoja negative për zonat rurale. Zhvillimet e tilla i shndërruan emigrimet fshat - qytet në formën më të rëndësishme të lëvizjes së brendshme të popullsisë, ndërsa faktori ekonomik është një nga shkaktarët më të rëndësishëm të këtyre migrimeve me pasojat në të gjitha fushat e jetës njerëzore.

Në Kosovë, migrimet fshat- qytet ishin intensive sidomos gjatë viteve të '70 dhe të '80 të shekullit XX, mirëpo kriza ekonomike dhe politike gjatë gjysmës së dytë të viteve '80 e sidomos gjatë viteve të '90, shkaktoj zvogëlim të emigrimeve të popullsisë nga zona rurale, por jo për një periudhë të gjatë pasi që në fund të viteve '90 të shek. XX dhe fillim të shek. XXI me përfundimin e luftës ndodhë një valë e re (masive) e migrimeve fshat-qytet në Kosovë si tërësi. Lufta me gjithë humbjet e mëdha në njerëz dhe dëme materiale, shkaktoi edhe ristrukturim drastik demografik të hapësirës (grumbullimin e

⁹ Islami H., (2012). "Aspekti etnik i migrimeve- Shqiptarët në rrjedhat e shpërnguljeve të dhunshme". Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, fq 276.

popullsisë në qytetet e mëdha), ndërsa disa zona rurale u zbrazen plotësisht nga popullsia (zonat kodrinore-malore) ose pësuan zvogëlime drastike të popullsisë.

Kontribut të madh në këtë drejtim dha edhe fakti se pas luftës, rindërtimi material i fshatit u zhvillua ngadalë dhe në mënyrë jo efektive kështu që mungoi kthimi i plotë dhe masiv i të zhvendosurve. Baza materiale për ekzistencë e banorëve të fshatit është më e dobët se sa e popullsisë së qyteteve. Kështu, në vitin 2004, të ardhurat për kokë banori në zonat rurale ishin për 33.5% më të ulëta se sa në zonën urbane, ndërsa të ardhurat për ekonomi familjare, ishin për 12.7% më të ulëta. Kërkimet për varfëri të realizuara nga UNDP, për të njëjtën periudhë tregojnë se popullsia rurale kishte shkallë më të lartë të varfërisë (49.2%), kurse papunësia në zonat rurale ishte 48.5% krahasuar me 39.6% në zonat urbane.

Edhe nga këto të dhëna të ofruara shihet se faktori ekonomik (ekzistencial) kontribuon në migrimet fshat- qytet. Në këto rrethana shtrohet pyetja:

- **A do të vazhdoi trendi i emigrimeve nga fshati kosovar?!**

Nuk ka dyshim se vazhdimi i shpërnguljeve sidomos e popullsisë se re (e cila zakonisht ka prirje për emigrim) edhe më tepër do ta rëndon situatën demografike dhe socio- ekonomike në zonat rurale dhe do të kufizonte mundësitë për rivitalizimin demografik dhe socio- ekonomik duke i shëndrruar këto zona në zona të cilat nuk mund ta ripërtrijnë vetveten në aspekt demografik e as në atë ekonomik. Nga numri i përgjithshëm prej 1,739,825 personave të regjistruar, në regjistrimin e popullsisë (prill 2011), prej tyre 517.992 persona apo rreth 30% e tyre kanë përjetuar të paktën një migrim.

Sikur edhe në vendet tjera edhe në Kosovë emigrimi i brendshëm është zhvilluar nga zonat rurale në zonat urbane dhe nga vendbanime më të vogla urbane në drejtim të kryeqytetit të Prishtinës duke përfshirë edhe zonën preferike të saj Fushë Kosovën edhe Graçanicën. Ky migrim në Kosovë ndikoi edhe në mbipopullimin e disa zonave urbane dhe atyre ndërurbane, dhe depopullimin e zonave rurale e kryesisht atyre kodrinore-malore. Të dhënat tregojnë se në vitet e fundit kemi një rishpërndarje të re të popullsisë brenda në Kosovë dhe vetë komunave.

Faktorët e ndryshëm që u përmendën ndikuan në një lëvizje të tillë, përfshirë edhe mungesën e infrastrukturës bazike në vendbanimet rurale (rrugët, kanalizimi, ujësjellësi) për një kohë të gjatë, derisa vitet e fundit dukshëm janë përmirësuar kushtet e infrastrukturës.

Arsyet kryesore të migrimit të brendshëm (regjistrimi i vitit 2011) janë ¹⁰:

- Punësimi - 5.8 %
- Arsimi & qëllime trajnimi- 2.8 %
- Familjare/ martesat- 73.4 %
- Luftës 1998-'99- 4.5%

¹⁰ "Migrimi Kosovar.(2014). Agjencia e Statistikave e Kosovës. Prishtinë. fq 53-54. E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/media/1379/migrimi-kosovar-2014.pdf>

- Tjera- 13.5%

Rritja e numrit të banorëve në qytet mund të shkaktojë ngarkesë në ofrimin e shërbimeve komunale në rast se nuk ka një planifikim të duhur siç është rasti i Kosovës. Kjo ndikon në masë të konsiderueshme në planifikimin për nevoja të edukimit, kujdesit shëndetësor, planifikimin urban, shërbimet publike etj. Përcjellja e migrameve të brendshme është shumë e rëndësishme edhe për faktin se edhe buxheti i komunave përcaktohet nga numri i banorëve dhe komunat duhet të dinë saktë se sa qytetarët pritet të shërbehen nga shërbimet komunale.

Bilanci i emigrimeve të brendshme sipas komunave

Referuar statistikave të migrameve të brendshme¹¹ bilancit migrues në nivel të komunave, mund të konstatohet se cilat janë zonat tërheqëse dhe cilat janë zonat emigruese, duke na mundësuar të konstatojmë balancin gjeografik dhe demografik të komunave¹².

Sa i përket bilancit të migrameve të brendshme në periudhën 2011-2021, në Kosovë 23 komuna karakterizohen me bilanc negativ, 12 me bilanc pozitiv ndërsa 3 komuna karakterizohen me bilanc negativ dhe pozitiv gjatë viteve të ndryshme. Sikur edhe në rastin e lëvizjeve migrues, komunat me numër të vogël të popullsisë rezidente, karakterizohen me emigrim më të ulët dhe kanë bilanc pozitiv të migrameve të brendshme. Në këtë grup hyjnë komunat Graçanicë, Novo Bërdë, Junik, Mamush, Ranillug, Partesh, Kllokot. Komunat të cilat gjatë kësaj periudhe karakterizoheshin me bilanc migrues herë pozitiv e herë negativ ishin komunat: Mitrovica e Veriut (nga viti 2018 bilanc negativ), Leposaviqi (deri në vitin 2015 bilanc negativ) dhe Hani i Elezit (nga viti 2016 bilanc negativ). Përjashtuar komunat e vogla me bilanc pozitiv migrues të brendshëm gjatë gjithë periudhës së shqyrtuar karakterizohen edhe komuna e mëdha: Prishtina, Fushë Kosova, Prizreni, Ferizaj dhe Istogu. Në kuadër të 23 komunave të cilat karakterizohen me bilanc negativ të migrameve të brendshme përfshihen edhe disa komuna me qendra regjionale siq është rasti me komunat: Pejë, Mitrovicë, Gjakovë dhe Gjilan. Megjithatë, komunat me bilancin më të lartë negativ sa i përket lëvizjeve të brendshme migruese në këtë periudhë ishin: Podujevë, Skënderaj, Kamenicë, Glogoc etj.

Nga të dhënat e prezantuara, mund të përfundohet se pole tërheqëse sa i përket migrameve të brendshme janë zona: Prishtinë- Fushë Kosovë- Graçanicë dhe qendrat regjionale Prizren e Ferizaj, ndërsa përjashtim këtu bëjnë komuna e Istogut e cila edhe pse qendër nën regjionale është kthyer në një pol tërheqës për regjionin e Pejës, ndërsa si zona depresive mund të konsiderohen të gjitha komunat me bilanc negativ të migrameve të brendshme e në veçanti komuna e Podujevës, Kamenicës, Skenderajt, Glogocit etj.

¹¹ Shih tabelen 3 në shtojcë

¹² Në migrimin e brendshme janë përfshirë vetëm personat që kanë migruar në aspektin territorial prej një komune në komunën tjetër dhe jo ata persona që kanë migruar brenda komunës së njëjtë.

EMIGRIMET E JASHTME - NDËRKOMBËTARE TË POPULLSISË

Sipas definicioneve dhe standardeve mbi emigrimin ndërkombëtar: një person është emigrant, nëse ai/ ajo ka lënë vendin e tij/saj të lindjes në mënyrë që të vendoset përgjithmonë në një shtet tjetër pa marrë parasysh nëse ai / ajo ka ndonjë status të veçantë në vendin në të cilin ka emigruar. Personi i vendosur në vendin që ka migruar (vendosur) është person rezident i atij vendi (shteti ku personi jeton, që do të thotë, shteti ku ai/ajo ka një vend për të jetuar, ku ai/ajo normalisht kalon periudhën ditore të pushimit. Udhëtimet e përkohshme jashtë atij vendit për: pushime, vizita tek miqtë apo të afërmit, për biznes, trajtim mjekësor apo pelegrinazh fetar, nuk e ndryshojnë vendin e qëndrimit të zakonshëm të personit¹³.


Emigrimi i popullsisë nga Kosova në vendet evropiane nuk është fenomen i ri. Kosova gjatë gjithë shekullit XX dhe fillimin e shekullit XXI ishte dhe mbetet territor tipik emigruese. Shkaktarët kryesor të cilat detyruan popullsinë të emigroj ishin dhe mbetet: niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, shkatërrimet nga luftërat, situata jo e favorshme politike etj. Ekzistojnë edhe arsye tjera që ndërlidhen me emigrimin siç është pakënaqësia e qytetarëve të Kosovës me gjendjen aktuale të perspektivës socio-ekonomike dhe me nivelin e përgjithshëm të mirëqenies manifestuar këto me shkallë të lartë të papunësisë sidomos në mesin e të rinjve, përqindje të lartë të njerëzve që jetojnë në varfëri etj. Kosova, për një periudhë më teper se një shekullorë karakterizohet me një bilanc negativ migracioni, që do të thotë se numri i emigrantëve është më i madh se numri i personave të kthyer- imigrantëve. Në periudhën 2000-2021, Kosovën e kanë braktisur mbi 420 mijë banorë (sipas statistikave të ASK), me mesatare prej mbi 21 mijë banorë brenda vitit edhe pse paraprakisht ekzistonte bindja se me lirinë dhe pavarësinë, Kosova do të shërohej edhe nga kjo plagë e vjetër shekullore.

Trendet e emigrimeve të jashtme të popullsisë 2011-2021

Emigrimet e jashtme janë një nga arsyet kryesore pse Kosova sot karakterizohet me trende të pavolitshme demografike siç janë: stagnimi i numrit të përgjithshëm të popullsisë me tendencë të rënies, trende të shpejta të uljes së lindshmërisë dhe shtimit natyror, përkeqsim në strukturat e popullsisë sipas moshës- moshim demografik , si dhe të strukturave tjera të popullsisë. Situata është aq e pavolitshme sa mund të konsiderohet edhe si krizë demografike. Nga perfundimi i luftës së vitit 1999, valë të fuqishme të emigrimit nga Kosova lidhen me dekadën e dytë të shekullit XXI me kulminacion gjatë viteve 2014 dhe 2015 të cilat lidhen edhe me krizën ekonomike dhe pasigurisë globale.

Përderisa në fillim arsyet e emigrimit ishin të karakterit ekonomik, tani humbja e shpresës dhe pasiguria për të ardhmen në Kosovë është kthyer në arsyet kryesore për emigrim. Emigrimet e dy dekadave të shekullit XXI janë valët më të pafavorshme deri tani. Ky trend po zhvillohet në rrethana të reduktimit të lindshmërisë, rënies së shtimit natyror, stagnimit me tendenca të rënies të numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe procesit të përshpejtuar të deformimit të strukturave të popullsisë sidomos asaj sipas moshës drejt plakjes së popullsisë.

¹³ Organizata Ndërkombëtare për Migracionin: E drejta migratore ndërkombëtare: Fjalorth i terminologjisë migratore.



Grafiku 1. Trendet e lindshmërisë, shtimit natyror, emigrimeve dhe bilancit migrues i jashtëm në Kosovës 2011-2021


Sikur edhe në shumë vende të botës, edhe në Kosovë statistikatat e emigrimeve janë jo të plota sepse shumë banorë nuk e çregjistrojnë vendbanimin e tyre në Kosovë përpara se të largohen ose e bëjnë këtë shumë kohë pas shpërnguljes. Megjithatë, edhe të dhëna të tilla të mangëta tregojnë se në periudhën 2011-2021 jashtë shtetit janë shpërngulur mbi 300 mijë banorë, numër ky shumë më i lartë (afër 190 mijë më shumë) se në periudhën 2001-2010, kur u shpërngulën mbi 119 mijë prej tyre.

	Numri i emigrantëve	Indeksi bazik 2011=100	Indeksi vargorë
2011	10695	100	-
2012	10335	96.6	96.6
2013	20246	189.3	195.9
2014	45333	423.9	223.9
2015	74734	698.8	164.9
2016	22017	205.9	29.5
2017	11263	105.3	51.2
2018	28164	263.3	250.1
2019	34911	326.4	123.9
2020	8724	81.6	24.9
2021	42728	399.5	489.8
Gjithsejt	309150	-	-

Tabela 1. Numri i emigrantëve nga Kosova 2011-2021 (sipas statistikave të ASK)

Ndonëse, statistikatat e emigrimeve janë jo të plota, ato janë të vetmet të dhëna zyrtare për numrin e emigrantëve të paraqitur në tabelën 1. Siç shihet nga tabela dhe grafiku mbi emigrimet e popullsisë në Kosovë 2011-2021, nga viti 2011 deri në vitin 2015 ka rritje të vazhdueshme të numrit të emigrantëve. Viti 2014 e posaçërisht 2015, paraqesin vitet me rritje ekstreme të numrit të emigrantëve ku numri i

emigrantëve në raport me vitin 2011 ishte rritur për 323.9% ose 4.2 herë (2014) dhe 598.8% ose afër 7 herë (2015). Përfunduar eksodin masiv dhe deportimin e rreth 1 milion shqiptarëve nga regjimi i Millosheviqit në vitin 1999, nga fundi i vitit 2014 dhe fillimi i vitit 2015 në Kosovë ndodhi një fenomen i paparë deri atëherë i emigrimit ilegal¹⁴. Gjithashtu edhe në periudhën 2017-2021 ka një rritje të vazhdueshme, përjashtuar këtu vitin 2020 kur Kosova karakterizohet me bilanc pozitiv migrues. Arsyeja kryesore për këtë është pandemia e sëmundjes COVID-19, për shkak të së cilës shumë vende mbyllën kufijtë e tyre, kështu që punësimi i shtetasve të huaj në këto vende u vështirësua ose u pamundësua. Kështu mbi 150 vende kishin vendosur masa të tilla kufizuese, duke e bërë këtë periudhë me më së shumti kufizimi të lëvizjes në historinë e udhëtimit ndërkombëtar¹⁵. Megjithatë, në vitin 2021, numri i emigrantëve është shumë më i lartë se në vitin 2020 (4.8 herë më i lartë) dhe i përafërt me vitin 2014, ndaj mund të pritet që pas vitit 2021 nuk do të ketë ulje të numrit të emigrantëve.



Grafiku 2. Numri i emigrantëve nga Kosova 2011-2021

Se emigrimet kanë marr përmasa shqetësuese e dëshmon edhe fakti se gjatë vitit 2021 Kosovën e kanë braktisur brenda ditës 119 persona ose çdo 12 minuta 1 person.

Bazuar në të dhënat preliminare gjatë 2022 gjendja vetëm sa është përkeqësuar edhe më tepër. Edhe më shqetësues është fakti se bazuar në sondazhe të ndryshme të realizuara në vend, rreth 60% e të anketuarve kanë shprehur dëshirën të ikin nga Kosova kryesisht gjenerata të reja (20 deri në 40 vjet) të cilët përbejnë kontingjentin kryesor demografik dhe lindshmërisë, kontingjentin e punës, të sigurisë etj., duke shkaktuar rënie të “kapitalit human”, si bartësin kryesor të zhvillimit socio-ekonomik.

¹⁴ Islami H (2018). “Push- Pull faktorët në migrimet e jashtme- qasjet teorike dhe rasti I Kosovës”. Studime Shoqërore 4. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Seksioni i Shkencave Shoqërore. Prishtinë. fq 33. E qashme: <https://ashak.org/botime/studime-shoqerore-4/>

¹⁵ Behrami S. “Emigrimet e popullsisë dhe pandemia”, Me rastin e 18 dhjetorit- Ditës Ndërkombëtare të Migrimeve, 17 Dhjetor 2020. E qashme në: <https://www.albinfo.at/emigrimet-e-popullsis-dhe-pandemia/>

Edhe përkunder faktit që Kosova balafaqohet me fluks shumë të lartë të emigrimeve, më shumë se gjysma e qytetarve të Kosovës (55.4%) pajtohen se emigrimet do të kenë ndikim negativ për zhvillimet e ardhshme në vend, 15.3% pajtohen se nuk do të ketë asnjë ndikim, 16.9% se nuk e dinë se çfarë ndikimi do të kenë, nërsa 11.6% pajtohen se emigracioni do të ketë ndikim pozitiv¹⁶.

Duke patur parasysh ecurinë e gjerëtanishme por edhe atë që pritet në zhvillimin ekonomik, mundësitë e punësimit dhe rrethanat tjera të pavoritshme edhe për një kohë duhet të priten lëvizje migruese të popullsisë me intensitet të pa zvogëluar. Fatkeqësisht institucionet e Kosovës kanë bërë shumë pak në adresimin e faktorëve nxitës të emigrimit siç janë: zhvillimi ekonomik, papunësia, perspektiva për një jetë më të mirë dhe të sigurtë, më të dinjitetshme etj.

Gjendja sa i përket emigrimeve mund edhe të përkeqësohet edhe më tepër me rastin e liberalizimit të vizave dhe bashkimit të Kosovës me EU e cila mund të nxis valë në rritje të emigrimeve duke pasur parasysh faktin se Kosova ngel prapa vendeve të EU në sferën socio-ekonomike, pasi që një ndër faktorët kryesor të migrameve është dallimi në të ardhura në mes vendeve të prejardhjes dhe mikpritëse. Një prirje e tillë bazohet edhe në praktikën e vendeve të ndryshme të cilat pas liberalizimit dhe anëtarimit në EU, janë ballafaquar me fluks të shtuar migrues.

Emigrimet e jashtme nga Kosova sipas komunave


Analiza e emigrimeve në nivel të komunave na ofron informacione në lidhje me dimensionin hapësinor të këtij fenomeni në Kosovë, si dhe konstatimin nëse ka pasur ndryshime të rëndësishme në periudha të caktuara kohore. Me qëllim të konstatimit të ndryshimit hapësinor dhe faktit nëse ka pasur ndryshime në intensitetin e emigrimit të jashtëm si tregues do të përdoret – shkalla e emigrimit e cila paraqet raportin në mes numrit të emigruarve në raport me numrin e popullsisë rezidente në vitin 2021 në komunën përkatëse (për 100 banorë). Numri i emigrantëve në raport me numrin e popullsisë rezidente në Kosovë dallon shumë në mes komunave. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë 2011 tregojnë se në komunat me numër të vogël të popullsisë rezidente, emigrimi ishte më i ulët siç janë: Shtërpca, Graçanica, Ranillugu dhe Mamusha nën 10%. Në këtë regjistrim Kosova kishte 21.4% të popullsisë jetonin jashtë vendit, ndërsa në mes 1-9% të popullsisë jashtë vendit ishin 9 komuna, 10-19% 12 komuna, 20-29% 13 komuna, 30-39% 3 komuna dhe mbi 40% 1 komunë. Në raport me popullsinë rezidente, numrin më të madh të popullsisë emigruese në regjistrimin e popullsisë 2011 e kishte Suhareka, afër 47% të popullsisë jetonte jashtë vendit, Klina 34.1%, Mitrovica 33.2%, Gjakova 31.4% etj¹⁷.

Se fenomeni i emigrimeve në shumë komuna ka marrë përmasa shqetësuese tregojnë edhe të dhënat edhe dallimi (rritja) e të dhënave mbi emigrimin në nivel komunal, mes regjistrimit të popullsisë 2011 dhe statistikave të emigrimit të vitit 2021. Bazuar në statistikën e Agjencisë së Statistikave të Kosovës në vitin 2021 pjesëmarrja e popullsisë jashtë vendit në Kosovë kishte arritur në 36.6% nga 21.4% në

¹⁶ “Women and migration in Kosovo: Exploring the data”. E qasshme në: <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2022-07/PPDataGenderStory.pdf>.

¹⁷ Migrimi Kosovar (2014), ASK. Prishtinë fq 19. E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/media/1379/migrimi-kosovar-2014.pdf>

regjistrimin e popullsisë 2011, ndërsa edhe në komunat e saja kisht rritje të konsiderueshme të kësaj pjesëmarrje. Kështu në mes 1-9% të popullsisë jashtë vendi ishin 6 komuna, 10-19% 7 komuna, 20-29% 6 komuna, 30-39% 8 komuna dhe mbi 40%, 11 komunë (40-49% 5 komuna, 50-59- 1 komunë dhe mbi 60% të përfshirë nga emigrimet ishin 5 komuna). Në raport me popullsinë rezidente, numrin më të madh të popullsisë emigruese në statistikat e Agjencisë së Statistikave të vitit 2021 e kishte Suhareka, 73.3% të popullsisë përfshirë nga emigrimet e jashtme, Obiliqi 70.1%, Gjilani 69.9%, Mitrovica 60.5%, Vushtrria 60.7% etj.




Grafiku 3. Numri i popullsisë emigruese në raport me popullsinë rezidente sipas komunave 2011 dhe 2021 shprehur në përqindje

Emigrimet sipas komunave 2011-2021

Emigrimet, sidomos ato të jashtme, vazhduan me intensitet të konsiderueshëm edhe gjatë periudhës 2011 - 2021. Gjatë kësaj periudhe, pothajse të gjitha komunat e Kosovës karakterizohen me bilanc migrues negativ duke përjashtuar këtu vitin 2020 kur për shkak të pandemisë (gjatë kohës kur lëvizjet, sidomos ato jashtë shtetit ishin të kufizuara) vetëm komuna e Prishtinës dhe Kaçanikut karakterizoheshin me bilanc migrues negativ, të gjitha komunat tjera në vitin 2020 karakterizohen me bilanc pozitiv. Nga të dhënat¹⁸ e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës tregojnë se në nivel të Kosovës në periudhën 2011-2021, mesatarisht 15.9 banorë (16 banorë në 100), janë përfshir nda emigrimi në raport me numrin e përgjithshëm të banorëve në vitin 2021.


¹⁸ Migrimi Kosovar (2014), ASK. Prishtinë fq 19. E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/media/1379/migrimi-kosovar-2014.pdf> dhe Vlerësimi i Popullsisë vite te ndryshme. Të qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/social/vleresimi-i-popullise>



Harta 1 dhe 2. Numri i popullsisë emigruese në raport me popullsinë rezidente sipas komunave në vitin 2011 dhe 2021 shprehur në përqindje

Sikur edhe në regjistrim të popullsisë 2011 edhe në periudhën 2011-2021, në komunat me numër të vogël të popullsisë rezidente, emigrimi ishte më i ulët siç janë: Parteshi, Graçanica, Zvecani, Zubin Potoku, Klllokoti Hani I Elezit, Mitrovica Veriore dhe Decani, komunat të cilat kishin nën 5 të emigruar në 100 banorë. Megjithatë, me këtë rast duhet nënvizuar se emigrimet e ulëta në disa komuna (sidomos në ato me shumicë të popullsisë serbe) mund të jenë edhe si pasojë e statistikave të mangëta (mospërfshirjes), por dhe për faktin se këto komuna tashmë janë përfshirë nga procesi i moshimit demografik (mungesë e potencialit migrues).

Gjatë periudhës 2011- 2021, në raport me popullsinë rezidente, numrin më të madh të popullsisë emigruese (në 100 banorë) e kishin komuna: Obiliqi 45.4%, Gjilani 40.3%, Kamenica 38.6% Vushtria 31.3%, Fushë Kosova 28.3%, Suhareka 26.6, Ferizaj 22.2%, Mitrovica 20.4%, Shtimja 20.4% etj. Gjithashtu duhet potencohet se emigrimet e jashtme janë formë dominuese e emigrimeve në gjithë periudhën e vështruar dhe pothajse në të gjitha komunat e Kosovës.



Harta 3. Numri i popullsisë emigruese në raport me popullsinë rezidente sipas komunave në periudhën 2011- 2021 shprehur në përqindje

SFIDAT KRYESORE

Sidat e emigrimeve të brendshme

Edhe pse qytetarët ligjërish janë të obliguar që çdo ndryshim të vendbanimit ta regjistrojnë adresën e tyre të re, kjo nuk ndodh gjithmonë. Ky problem, është konstatuar edhe me rastin e regjistrimit të popullsisë 2011 (rasti i komunës së Prishtinës) por edhe në Draft Strategjinë Shtetërore të Migrimit 2020-2024 si dhe në Profilin e Zgjeruar të Migrimit.

Draft Strategjia Shtetërore e Migrimit 2020-2024 është dokumenti i parë strategjik i cili adreson migrimin e brendshëm. Si i tillë, ky dokument ka paraparë intervenime ligjore, institucionale dhe të ngritjes së kapaciteteve me qëllim të ndërtimit të një sistemi të besueshëm për të monitoruar lëvizjet e brendshme migratore dhe zhvillimin e politikave përkatëse të bazuar në të dhëna. Këto intervenime, përfshijnë por nuk kufizohen në këto elemente: 1.) Avancimin e sistemit ekzistues të regjistrimit brenda komunave duke zhvilluar module të reja lidhur me ndryshimin e adresës; 2.) Krijimin dhe funksionalizimin e një baze unike e të dhënave për migrimin e brendshëm bazuar në Ligjin Nr.02/L-121 për Vendbanimin dhe Vendqëndrim; 3.) Organizimin e fushatave vetdijësuese lidhur me obligimin ligjor për të lajmëruar dhe regjistruar ndryshimin e adresës nga një komunë në tjetrën dhe 4.) Zhvillimi i programeve për ngritje të kapaciteteve të zyrtarëve në nivel qendror dhe lokal, përgjegjës për regjistrimin e ndryshimit të adresës dhe analizimin e të dhënave.¹⁹ Megjithatë një angazhim i tillë nuk duhet të fokusohet vetëm në migrimet e brendshme por edhe në ato të jashtme ku problemet e lartpërmendura janë edhe më të theksuara.

Emigrimet e brendshme (duke përfshirë edhe ato fshat-qytet) kanë ndikim shumë më të vogël demografik dhe socio-ekonomik për vendin se sa emigrimet e jashtme. Nga këto emigrime potenciali demografik socio-ekonomik por edhe i sigurisë, mbetet brenda vendit, megjithatë, shkaton probleme të natyrave të ndryshme. Ndryshime në shpërndarjen gjeografike të popullsisë (koncentrimin e popullsisë në disa zona dhe zbrazjen e zonave tjera) në nivelin e ulet të zhvillimit ekonomik në të cilën ndodhet Kosova dhe infrastruktura e dobët ka shkaktuar vështirësi për jetë në vendbanimet urbane (posaçërisht në qytete e mëdha dhe periferitë e tyre) që ka shkaktuar fenomenin e ruralizimit të qyteteve dhe është manifestuar me probleme të shumta të natyrës ekonomike, sociale, ekologjike dhe infrastrukturale. Problemet ekonomike kanë të bëjnë me: presion në punësim (papunësinë e lartë në vendbanimet urbane), e cila përcjellet me rritjen e varfërisë, dhunës, kriminalitetit, ekonomia joformale etj. Problemet sociale kanë të bëjnë me: ngarkesën e madhe të gjitha institucioneve në vendbanimet urbane (shkollave, shtëpive të shëndetit, kopshteve etj) dhe braktisja e atyre në fshatra, ngarkesë në institucionet arsimore dhe shëndetsore të disa zonave dhe zvogëlimin ose edhe zbrazjen e këtyre institucioneve në zona tjera.

¹⁹ “Kosova trendet e migracionit kërkojnë një qasje të re strategjike”. (2020), Balkans Policy Research Group, Prishtin, fq25. E qasshme në: <https://balkansgroup.org/kosova-trendet-e-migracionit-kerkojne-nje-qasje-te-re-strategjike/>

Problemet në infrastrukturë kanë të bëjnë me: ndërtimet dhe mbindërtimet pa plan, ndertimet e “egra” të cilat kanë marr përmasa shqetësuese në shumë zona në qytetet e mëdha dhe periferitë e tyre, në shumicën e rasteve me mungesë elementare të infrastrukturës urbane, zbrazjen e fshatrave të tëra (sidomos territoret kodrinore-malore), ngarkesa e infrastrukturës urbane, problemet në furnizim me ujë të pijshëm, ngarkesa e rrjetit të rrugëve urbane etj. Problemet ekologjike kanë të bëjnë me: shkallën e lartë të ndotjes së parametrave mjedisor (ajrit, ujit, tokës) zhurma, problemet me mbeturina të ngurta urbane, numri i madh i automjeteve etj.

Këto probleme në rrethanat e Kosovës janë edhe më të shprehura për faktin se emigrimet fshat- qytet zhvillohen pa përgatitje paraprake dhe në mënyrë stihike. Për zgjidhjen e këtyre problemeve është e nevojshme përgatitja e planeve të mirëfillta zhvillimore dhe urbane të komunave dhe zonave brenda komunave, orientimin drejt urbanizmit sekondar si dhe përgatitjen e një Strategjie të Zhvillimit të Urbanizimit në Kosovë²⁰. Gjithashtu, vendet e ndryshme në perballje me sfidën e mbi-urbanizmit si hap për adresimin e këtij problem kanë ndërmarrë masa për zhvendosjen e një pjese të qeverisë dhe institucioneve tjera nga kryqyteti/qytetet e mëdha në drejtim të qyteteve më të vogla për të kompensuar rënien dhe nxitur zhvillimin e tyre.

Në të njëjtën kohë njohja me trendet dhe drejtimin emigrimeve të brendshme (regjistrimi i lëvizjeve fshat-qytet dhe anasjelltas apo komunë-komunë) është shumë i rëndësishëm për faktin se u mundësojnë vendimarrësve në orientimin e politikave publike në fushën e edukimit, punësimit, çështjeve sociale, planifikimit të buxhetit, investimeve nga jashtë, etj, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik në vend.

Sidat e emigrimeve të jashtme

Situata e pafavorshme ekonomike në Kosovë, rënia e standardit të jetesës për shumë qytetarë, pamundësia për të gjetur punë edhe në profesion, pritja e gjatë për punësim, paga e pamjaftueshme duke marrë parasysh kualifikimin dhe klima jo e favorshme, humbja e perspektives për jetë më të mirë sidomos te të rinjtë janë disa nga faktorët më të rëndësishëm ekonomik që i shtojnë individët të vendosin të emigrojnë përkohësisht ose përgjithmonë nga Kosova. Në hulumtimin e UNDP-së, Puls Publik të vitit 2022, situata e pafavorshme ekonomike- papunësia (36.4%) dhe varfëria (21.1%) etj., janë problemet më kryesore me të cilat përballet Kosova aktualisht²¹. Papunësia, varfëria dhe kërkimi për një të ardhme më të mirë për familjen e tyre mbeten arsye kryesore për migrimin nga Kosovarët sidomos tek të rinjtë.

²⁰ Behrami S., Bajraktari F. (2021). ‘Dimensioni demografik i Agjendes 2030- perspektiva dhe sfidat e Kosovës’. Instituti për Politika Zhvillimore INDEP. Prishtinë fq 51-52. E qasshme në: https://indep.info/wp-content/uploads/2021/07/INDEP_Dimensioni-i-Demografikes-se-Agjendes-2030_14072021.pdf

²¹ Puls publik XXII, USAID, UNDP, Prishtin, prill 2022 fq 20. E qasshme në: https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2022-06/Public%20Pulse%202022%20-%20ALB_0.pdf

Me këtë nivel të lartë të papunësisë dhe varfërisë, migrimi nuk është dëshirë, por domosdoshmëri për mbijetesë, kështu që për të ndaluar emigrimin, patjetër duhet një zhvillim i shpejtë ekonomik.

Tek të rinjtë arsyeja numër një për të konsideruar emigrimin ishte mungesa e mundësive për punë në Kosovë sipas 67% të të anketuarve (55% në 2018). Një pjesë tjetër prej 45% deklaroi mungesën e perspektivës personale si arsye (32% në 2018) dhe 39% përmendën situatën e pafavorshme ekonomike në familje/nivelin e ulët të të hyrave (38% në 2018). Gjetjet e grupeve të fokusit nënvizuan më tej çështjet mungesën e punësimit, vështirësitë financiare dhe mungesën e perspektivës si shkak të konsiderimit të mundësive për emigrim²².

²² “Sfidat dhe këndvështrimet e të rinjve në Kosovë” (2021). UNDP. Prishtinë fq 28. E qasshme në: <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/ks/YouthChallengesandPerspectivesinKosovoALB.pdf>

PASOJAT NGA EMIGRIMET

Pasojat demografike, ekonomike dhe sociale të emigrimit të popullsisë janë të shumta dhe kanë efekt të dyfishtë. Ato lënë pasoja në vendin e origjinës dhe në vendin e destinacionit, kryesisht duke ndryshuar karakteristikat demografike të atyre zonave: madhësinë dhe shpërndarjen hapësinore, potenciali i fertilitetit, vdekshmëria dhe struktura e popullsisë. Gjithashtu, duhet theksuar se emigracioni ka dy efekte kohore: i menjëhershëm, i cili zvogëlon numrin e banorëve me largim, dhe afatgjatë (i vonuar), që manifestohet në faktin se popullsia që largohet nga vendi i origjinës në të njëjtën kohë zvogëlon numrin e lindjeve, shtimin natyror, martesave etj., në të ardhshme që popullata e përfshirë nga procesi i emigrimit do të përjetonte gjatë jetës së tyre në vendin e origjinës. Gjithashtu emigracioni fillestar ndikon negativisht në karakteristikat strukturore të popullsisë, veçanërisht në përbërjen sipas moshës (duke përshpejtuar plakjen e popullsisë vendore) dhe në këtë mënyrë edhe në komponentët e lëvizjes natyrore.

Në njëzet vitet e fundit, Kosova karakterizohet me emigrime masive sidomos të të rinjve me arsim të lartë, por kohëve të fundit është shtuar emigracion jo vetëm si individë, por edhe familje të tëra²³. Të gjithë ata të rinjë që emigrojnë, në shumicën e rasteve nuk largohen vetëm, por me familje e shumë të tjerë krijojnë familje në vendin mikpritës duke ndikuar kështu ndjeshëm në pasqyrën demografike kosovare. Pasojat e migrimit reflektohen në madhësinë e popullsisë, shkallën e lindjeve, shtimin natyror, strukturën e popullsisë (demografike, ekonomiko-sociale, etnike etj.),- rritje të përqindjes së të moshuarve në popullsinë e përgjithshme, sistemin e sigurisë etj.

Pasojat demografike

Analiza e tendencave të emigracionit në të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen është veçanërisht i rëndësishëm kur diskutohen pasojat demografike të emigrimit. Çështjet demografike janë të një rëndësie kyçe për zhvillimin e secilit të shtetit sepse nuk është e mundur të arrihet zhvillim në kushte të pafavorshme demografike ku emigrimet luajnë rol të rëndësishëm.

Tre janë arsye kryesore pse emigracioni është problemi kryesor i qëndrueshmërisë demografike të Kosovës por edhe më gjerë: (1) Sasiore - duke marrë parasysh numrin e madh të emigrantëve, (2) Cilësore - duke marrë parasysh strukturën (demografike, ekonomiko-sociale, arsimor etj.) të popullatës të përfshirë nga emigrimi dhe (3) kohore - duke pasur parasysh kohëzgjatjen e këtij procesi²⁴. Emigrimet ndikojnë në madhësinë e popullsisë duke shkaktuar humbjen e asaj pjese të popullsisë e cila përbën potencial zhvillimi, nivelin e lindjeve (me rënie të lindjeve), rritjes natyrore të popullsisë dhe strukturat e popullsisë (demografike, ekonomike, sociale, etnike dhe të tjera), përcjellur kjo me shpopullim natyror, emigracionin e trurit (brain drain), plakjes të popullsisë etj.

²³ Behrami S (2022), "A po shndërrohen emigrimet e popullsisë në kërcënim të përgjithshëm për Kosovën" <https://telegrafi.com/po-shnderrohet-emigrimi-popullsisë-ne-kercenim-te-pergjithshem-per-kosoven/>

²⁴ Sipas Wertheimer-Baletić (2004), Depopulacija i starenje stanovništva – temeljni demografski procesi u Hrvatskoj. Društvena istraživanja, 13 (4-5 (72-73)), 631-651.

Numri i emigrantëve ka ndikuar drejtpërdrejtë në stagnimin me tendenc të rënies të numrit të banorëve të përhershëm të Kosovë në periudhën 2011-2021. Përveç ndikimit të drejtpërdrejt në numrin e popullsisë emigrimet gjithashtu kishte edhe efekt indirekt. Kosova humbi drejtpërdrejt njerëzit që emigruan, por indirekt edhe fëmijët e tyre që largohen bashkë me prindër por edhe ata të cilët lindin në vendin e destinacionit nga këta prindër. Përveç pasojave të lidhura me numrin e banorëve, emigracioni ndikon edhe në nivelin e lindjeve, shtimin natyror, plakjen e popullsisë etj., me të cilat pasoja Kosova veç se ka filluar të ballafaqohet.

Për shkak se nga Kosova ndër vite ka emigruar kryesisht popullata më e re, më aktive dhe të aftë për riprodhim (20-40 vjeç), që nënkupton zvogëlim e grupeve fertile, gjë që çon domosdoshmërisht në një uljen e lindjeve, por edhe në rritjen e shkallës së vdekshmërisë sepse nga emigrimet perfshihen kategoritë e popullsisë që është më pak e predispozume ndaj rrezikut të vdekjes. Për më tepër, largimi i të rinjve jo vetëm që zvogëlon potencialin demografik të popullsisë, por në të njëjten kohë zvogëlon edhe grupet profesionale që vështirëson edhe mundësinë e shoqërisë kosovare drejt një zhvillimi më cilësor dhe modern. Si pasojë e emigrimeve por jo vetëm, në Kosovë që nga shpallja e pavarësisë e deri me sot kanë lindur rreth 380 mijë banorë të rinj. Megjithatë trendi i zvogëlimit të lindjeve është shqetësues. Këtë më së miri e argumenton fakti se përderisa në vitin 2008 Kosova kishte 34399 lindje në vitin, në 2021 ky numër ra në 22830 lindje.

Për përmasat e zvogëlimit të numrit të lindjeve më së miri flet fakti se në Kosovë në vitin 2008 brenda ditës kanë lindur mesatarisht 94 foshnje ndërsa në vitin 2021 ky numër zvogëlohet në 62 lindje në ditë. Gjatë periudhës së pavarësisë lindshmëria në Kosovë u zvogëlua për -33.6% me zvogëlim prej 2.3% në vit. Në të njëjtën periudhë në Kosovë kanë vdekur rreth 122 mijë banorë. Për dallim nga lindshmëria numri i rasteve të vdekjeve gjatë kësaj periudhe ka shënuar trend të rritjes. Kështu përderisa në vitin 2008 në Kosovë kanë vdekur 6852 persona në vit, në vitin 2021 kjo shifër gati dyfishohet për të arritur në 13019 persona. Thënë më ndryshe, përderisa në vitin 2008 brenda ditës kanë vdekur mesatarisht rreth 19 persona, në vitin 2021 numri mesatar i të vdekurve brenda ditës arrin në 36, ku ndikimi I pandemic Covid 19 është i konsiderueshëm.

Shtimi natyror i popullsisë në 15 vite pavarësi në Kosovë ishte 258 mijë banorë, që është dukshëm më i ulët se emigrimet në të njëjtën periudhë. Gjithashtu trendi i rënies së shtimit natyror është edhe më i shpejtë se sa numri i lindjeve. Përderisa në vitin 2008 popullsia e Kosovës shtohet për 27547 banorë të rinjë, në vitin 2021 shtimi natyror bie në 9811 banorë. Kështu popullsia e Kosovës në vitin 2008 brenda ditës është rritur për 76 banor të ri, ndërsa në vitin 2021 për vetëm 27 banorë²⁵. Se emigracioni ka ndikim të konsiderueshëm në rënien e lindshmërinë si dhe shtimin natyror, e deshmon edhe rritja e pjesëmarrjes së lindjeve dhe shtimit natyror të realizuar jashtë vendit. Kështu në periudhën 2011 - 2021, pjesëmarrja e lindjeve jashtë Kosovës ka rritur pjesëmarrjen nga 19.3% në 31.8% të numrit të

²⁵ Behrami S (2023), "Sfidat demografike të Kosovës në 15 vjet pavarësi". E qasshme në: <https://demokracia.com/sfidat-demografike-te-kosoves-ne-15-vjet-pavaresi/> dhe <https://ekonomiaonline.com/sfidat-demografike-te-kosoves-ne-15-vjet-pavaresi/>.

përgjithshëm të lindjeve, cka do të thotë se emigrimi ka marrë me vete edhe një pjesë të konsiderueshme të lindshmërisë- rreth 1/3.

Rënia shumë e shpejt e shtimit natyror dhe emigrimet selektive (grup moshat 20-39 vjet përbëjnë afër gjysmën e emigrantëve), kanë përshpejtuar procesin e plakjes së popullsisë. Kështu, deri sa në vitin 2011 grup moshat mbi 60 vjet përbënin 9.6% te popullsinë, në vitin 2021 kjo pjesëmarrje u rrit në 13.3% . Në të njëjtën kohë grup moshat 0-19 vjet, kanë treguar tendencë të zvogëlimit të pjesëmarrjes nga 38.1% në 32.3%. Plakja e popullsisë përcillet me pasoja negative për zhvillimet demografike, ekonomike, sociale etj. Përveq në sferën demografike, emigrimet kanë ndikuar që diaspora kosovare të ketë strukturë më të volitshme se sa popullsia rezidente në Kosovë sa i përket popullsisë aktive dhe jo aktive. Kështu, përderisa në Kosovë popullsia jo aktive përbën 35% , në diasporë kjo pjesëmarrje është 19%, ndërsa sa i përket popullsisë aktive, pjesëmarrja në Kosovë është 65% ndërsa në diasporë 81%²⁶. Edhe raporti i varësisë është shumë më i favorshëm te diaspora (32.5%) se sa te popullsia rezidente në Kosovë (53.2%)²⁷.

Perspektiva e zhvillimeve të ardhshme demografike në Kosovë tregon se zhvillimet e pa favorshme demografike në dekadat e ardhshme vetëm sa do të thellohen. Kështu, si pasojë e zvogëlimit të kontigjentit të femrave të cilat futen në fazen riprodhuese (15-49 vjec) për rreth 35% në periudhën 2011-2061 dhe zvogëlimit të pjesëmarrjes së këtyre grupmoshave nga 54% në 36% (në numrin e përgjithshëm të femrave) pa dyshim që do të përcillet me uljen e normës së lindshmërisë dhe shtimit natyror në Kosovë. Parashikimet për kontigjentin e ri fertil femëror (20-29 vjet), janë edhe më të “zymëta”, meqenëse ky kontigjent në periudhën e njëjtë do të zvogëlohet për më tepër se 40%.

Në të njëjtë kohë, emigrimet selektive do të ndikojnë në përkeqsimin e gjendjes demografike. Sa i përket strukturave të popullsisë në radhë të parë në strukturën e popullsisë sipas moshës drejt thellimit të plakjes demografike. Se Kosova do të futet thellë në procesin e plakjes demografike deri në përfundimin e gjysmës së parë të shkullit XXI, më së miri e argumenton fakti i rritjes së pjesëmarrjes së grup moshave mbi 65 vjet në popullsinë e përgjithshme nga 6.9% (2011) në mbi 30% (2061). Plakja demografike si proces karakterizohet me pasoja negative si në sferën demografike ashtu edhe në atë socio-ekonomike, të sigurisë etj. Për të parandaluar plakjen e popullsisë për shkak të mbizotërimit të moshave të reja në flukset migratore, është i nevojshëm dekurajimi i emigrimit të jashtëm të popullsisë në moshë të re, nëpërmjet përmirësimit të kushteve, mundësive, aksesit dhe integritetit të rinjve në formimin profesional, arsimin profesional, arsimin universitar në degë të kërkuara nga tregu dhe në tregun e punës.

²⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës.

²⁷ “Rezultatet preliminare të regjistrimit të diasporës” (2017), Ministria e Diasporës, Prishtinë, fq 121.

Pasojat socio - ekonomike

Emigrimit të popullsisë të moshës së punës kanë pasojë jashtëzakonisht negative për ekonominë prandaj kontrollimi (ngadalësimi ose edhe frenimi) i këtij procesi është jashtëzakonisht i rëndësishëm për perspektivën ekonomike të vendit. Përveç pasojave demografike të përmendura, emigrimit kanë pasojë të shumta të rëndësishme edhe në sferën ekonomike. Edhe pse në shikim të parë mund të duket se emigracioni rezulton përkohësisht në një rënie të shkallës së papunësisë në vendin e origjinës, në fakt ky percetim mund të jetë vetëm një mit sepse “emigrimi nuk ndikon, ose ndikon shumë pak (në mënyrë të pa rëndësishme), në uljen e papunësisë në vende origjinën”²⁸. Prandaj efektet pozitive të emigrimit duhen kërkuar në drejtime tjera.

Emigrimi i popullsisë ka ndikim negativ në zhvillimin ekonomik të vendit përmes: rritjes së ulët e PBB-së për kokë banori, ngadalësimi i rritjes ekonomike, humbjen e fuqisë punëtore, uljen e konkurrencës dhe ndikimin negativ në sistemin shoqëror dhe pensionet, emigrimin e personave të kualifikuar etj. Kosova me shkallë të papunësisë prej rreth 30% (te grup moshat e reja papunësia arrin edhe deri në 50%), shkallë të varfërisë rreth 20 %, standardin e ulët të jetesës, nivelin e ulët të pagave (më të ulët edhe në rajon) parqet vend me potencial shumë të lartë të emigrimit. Sipas ekspertëve të ekonomisë në periudhën pas luftës, Kosova ka pasur një rritje ekonomike e cila nuk mund të konsiderohet e pa qëndrueshme dhe e pamjaftueshme për të zbutur problemet ekonomike dhe sociale, siç janë papunësia dhe varfëria ndërsa motivi kryesor për të emigruar sidomos tek të rinjtë është papunësia. Pasojat sociale të emigrimit të të rinjve janë të dukshme nëpërmjet humbjes së kapitalit të investuar, d.m.th të rinjtë që shpërngulen marrin me vete investimet e mëparshme të shoqërisë dhe familjes në edukimin dhe arsimin e tyre. Shteti u siguron arsim, për nxënës të mirë jep bursa dhe mundëson zhvillimin profesional, por është një dukuri shumë e zakonshme që pikërisht në raste të tilla, kur i nevojiten më shumë shoqërisë, largohen dhe gjejnë punë më të mirë në shtete të tjera.

Emigrimi i fuqisë punëtore, negative në ekonominë vendore reflektohet edhe me reduktimin e konsumit, rrjedhimisht edhe të TVSH-së së arkëtuar, kontributeve të paguara dhe taksave mbi të ardhura. Padyshim një ndër humbjet më të mëdha nga emigrimet të fuqisë punëtore janë kostot e investimit të shoqërisë në një person nga lindja deri në momentin e largimit nga vendi ku përfshihen edhe shpenzimet e ushqimit, strehimit, shkollimit etj. Pjesëmarrja e lartë e emigrimit të të rinjve është si një plagë e hapur për çdo ekonomi me pasojë dhe dëm shumë të madh, që nuk lejon qëndrim indiferent ndaj fenomenit, por në të njëjtën kohë kërkon ndërmarrjen e hapave konkret të menjëhershëm drejt përmirësimit dhe plotësimit të kërkesave të të rinjve. Edhe pse jo të plota, sipas vlerësime janë mbi 21 mijë njerëz që emigrojnë nga Kosova çdo vit, dhe një pjesë me e madhe janë të rinj, të cilët kanë pjesën më të madhe të karrierës së tyre profesionale përpara. Kjo do të thotë se çdo sektor ekonomik në Kosovë, çdo vit humb një numër i madh të rinjve, forcën, aftësitë,

²⁸ Meznaric S (2014) “Novi analiticki elementi u promisljanju migracija”. Në V. Puljiz, I. Tica and D. Vidovic., eds. Migracije i razvoj Hrvatske: Podloga za hrvatsku migracijsku strategiju. Zagreb: Croatian Chamber of Economy. Pp 191 (175-195).

kreativitetin dhe talentin e tyre, të cilat janë të nevojshme për avancimin e të gjithë sektorëve ekonomik të vendit.

Numri më i madh i përlogaritjeve për ndikimin e emigrimit të të rinjve nga Kosova, veçanërisht të atyre me arsim të lartë, në ekonominë kosovare, shikohen vetem nga investimet në arsimimin e këtyre njerëzve, nga shkolla fillore në të mesme e deri në fakultet. Edhe këto të dhëna tregojnë për humbje të konsiderueshme për Kosovën por që janë të pa krahasueshme me humbjet e sektorëve tjerë²⁹. Të rinjtë përshtaten më lehtë me ndryshimet, me futjen e teknologjive të reja dhe të inovacioneve, të cilat janë një forcë shtytëse për rritjen e produktivitetit. Numër të madh i të rinjëve që emigrojnë në vit, do të jetë faktor që progresi dhe ndryshimit në shumë sektorë të jenë më të ngadalshëm se sa do të ishin sikur të ishin në shërbim të vendit; ekonomia është thjesht më pak dinamike dhe produktivitet më të ulët pa ta. Është shumë e vështirë e ndoshta edhe e pamundur të maten të gjitha ndikimet negative të emigrimeve për ekonominë e vendit, për këtë arsyeje shpeshherë lihet mënjanë nga vëmendja dhe ballafaqimi me këto efekte. Nuk ka dyshim se emigrimet karakterizohen edhe me pasojat pozitive që janë fluksi i parave- remitancave, që Kosova pranon nga qytetarët e saj me qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm që punojnë jashtë vendit.

Në Kosovë në dekadën e fundit, remitencat kanë shënuar rritje të vazhdueshme, pavarësisht krizave globale ekonomike, shëndetësore, politike etj. Në vitin 2021 nga diaspora janë pranuar 1,143.9 miliardë Euro që në raport me vitin 2008 kanë treguar rritje për 541.2 milionë Euro ose 88.9%. Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, shuma totale e dërgesave financiare/remitancave në Kosovë nga diaspora që nga shpallja e pavarësisë në 2008 e deri në vitin 2021 është 9,874 miliardë Euro. Megjithatë, ky potencial ende mbetet jo sa duhet i shfrytëzuar dhe i kanalizuar në aktivitetet produktive që do të kishin efekte zinxhirore ekonomike. Gjysma e remitancave në para të gatshme janë përdorur për konsum, 18% janë përdorur për ndërtimin e shtëpive dhe për riparime, 17% për qëllime shëndetësore, 15% për arsim dhe vetëm një pjesë modeste prej 3% përdoret për investime, që tregon se vetëm një pjesë shumë e vogël e remitancave të pranuar në para të gatshme investohen në aktivitete prodhuese/ndërmarrëse (më pak se 4%)³⁰. Megjithatë, nuk ka dyshim se këto remitanca janë ndihmë e madhe financiare nga emigrantët për familjet e tyre dhe të afërm në Kosovë sidomos në kohë krizash.

Nuk ka dyshim që rritja e vazhdueshme e remitancave do të jetë ndikuar edhe nga rritja e numrit të emigrantëve, megjithatë mbetet që nga hulumtimet e ardhshme të konstatohet se si dhe në çfarë mase u rrit vëllimi i këtyre strukturave e këtyre remitancave në përputhje me flukset e reja të emigrantëve nga vendet e ndryshme. Një tjetër anë pozitive e emigrimit është zhvillimi i potencialit social, kulturor, teknologjik, inovativ dhe çdo kapital tjetër që emigrantët mund të marrin jashtë dhe më pas të transferojnë, investojnë dhe aplikojnë pjesërisht në vendin e origjinës. Një transferim i tillë mund të arrihet përmes investimeve direkte përmes investimeve të tyre financiare, teknike dhe logjistike në

²⁹ Për më tepër për investimet në arsim të emigrantëve shih: How much does youth emigration cost Kosovo? E qashme në <https://www.wfd.org/story/how-much-does-youth-emigration-cost-kosovo>.

³⁰ Behrami S (2022). "Emigrimet e popullsisë – një mundësi e pashfrytëzuar për zhvillim lokal në Kosovë", INDEP, Prishtinë fq 29 cituar sipas "Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018", Ministria e Diasporës, Prishtinë 2014, fq18.

ekonominë e Kosovës, pavarësisht nëse ata do të kthehen në Kosovë apo do të mbeten pjesë e një fluksi të përhershëm emigrantësh.

Autoritetet në Kosovë mund të bëjnë shumë për të hequr barrierat dhe për të krijuar mundësi të reja për pjesëmarrje të diasporës në zhvillimin ekonomik të vendit, para së gjithash duke ndërmarrë aktivitete të caktuara për të përcaktuar se sa e madhe dhe ku ndodhet diaspora, duke zhvilluar lidhje më të forta me organizatat në diasporë, duke lehtësuar përfshirjen e anëtarëve të diasporës në zhvillim, përfshirjen e përfaqësuesve të diasporës në përgatitjen e strategjive zhvillimore, trajtimin e vecantë të investimeve nga diaspora, ndërtimin e institucioneve që do të lehtësojnë zhvillimin e marrëdhënieve me diasporën etj. Me qëllim të zbutjes së pasojave demografike, ekonomike, sociale etj., të emigrimeve të jashtme Kosova duhet të zhvillojë një strategji kombëtare në drejtim të nxitjes së lidhjeve por edhe të tërheqjes së emigrantëve në Kosovë përmes politikave ekonomike në rast të investimit të tyre në Kosovë e jo që investimet e emigrantëve të trajtohen si investime të jashtme.

Praktikat e vendeve të ndryshme kanë treguar se emigrimi, veçanërisht nëse është afatshkurtër ose afatmesëm, gjatë të cilit emigrantët fitojnë njohuri të reja, përvojë, kapital financiar dhe social gjatë qëndrimit të tyre jashtë vendit, mund të shihet si një burim i rëndësishëm në zhvillimin e ardhshëm social dhe ekonomik të Kosovës, kuptohet, nëse përcillet me masa të mirëfillta të politikave integruese drejt kthimit të tyre në atdhe.

Pasojat në sistemin arsimor

Edhe pse si pasojë më e rëndë e krizës demografike, llogariten pasojat në trendin e fuqisë punëtore – tregun e punës, sistemin e mbrojtjes sociale, sistemin shëndetësor etj., në realitet norma e ulët e lindshmërisë dhe emigrimeve në periudha afatgjate, më së tepërmi godet kontingjentet e popullsisë të moshave shkollore. Në 15 vjet pavarësi, numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është zvogëluar për -101.115 nxënës. Kosova në 15 vjet pavarësi ka humbur afër 1/3 e numrit të nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët. Kështu, Kosova në vitin 2022 kishte 5322 paralele më pak se në vitin 2008 (19 nxënës për paralele). Statistika edhe më shqetësuese janë ato të numrit të nxënësve të regjistruar në klasën e parë ku rënia është edhe më e madhe.

Edhe pse në arsimin e mesëm të lartë ndikimi i zhvillimeve negative demografike pritej të shfaqej më vonë megjithatë nga viti shkollor 2011/2012 edhe ky nivel i shkollimit karakterizohet trendi i zvogëlimit të numrit të nxënësve. Kështu në raport me vitin 2008 numri i nxënësve në vitin 2022 është zvogëluar për më shumë se 20 mijë, ndërsa në raport me vitin 2012 për më shumë se 38 mijë nxënës. Në raport me vitin 2012 në vitin 2022, Kosova kishte mbi 2 mijë paralele më pak në arsimin e mesëm. Vetëm në universitetet e Kosovës në këtë periudhë është shënuar rritje e numrit të studentëve edhe pse edhe në këtë nivel, në katër vitet e fundit janë shënuar trendë shqetësues të zvogëlimit të numrave të studentëve. Në pesë vitet e fundit (2017/2021) numri i studentëve është zvogëluar për rreth 30 mijë që është treguesi më i mirë për mungesën e perspektives dhe emigrimin masiv të të rinjve nga Kosova. Vetëm në shtatë vitet e fundit është konstatuar zvogëlim i numrit të nxënësve për: 16.1% në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, 11.2% në arsimin e mesëm të lartë dhe 21.3% në fakultete (në pesë vitet e fundit).

Këto lëvizje negative të trendit të numri të nxënësve në radhë të parë është si pasojë e rënies të natalitetit në Kosovë në të cilën kontribuon të jashtëzakonshëm kanë edhe emigrimet të cilat sot kanë marrë përmasa shqetësuese. Kështu pra ndikimi i emigrimeve në lëvizjen e numrit të nxënësve është direkt (largimi i nxënësve në emigracion me prindër e pas përfundimit të shkollimit të mesëm edhe si fuqi punëtore) dhe indirekte (përmes lindshmërisë me zvogëlimin e kontigjentit të popullsisë të aftë për riprodhim).

Nuk ka dyshim që viset më të goditura nga ky fenomen janë zonat kodrinoro-malore, zonat e thella rurale dhe vendbanimet e zonave kufitare ku numri i nxënësve dhe paraleleve është në rënie të vazhdueshme sidomos në paralelet e klasave të para të shkollave fillore. Kështu, këto zona por edhe shumë vendbanime rurale në periferi të zonave urbane, trendi i mbylljes së shkollave do të vazhdoj, veçanërisht në zonat e para. Kjo do të çoj gjithashtu në ulje të nevojës për staf profesional mësimor dhe arsimor, si dhe në një ulje graduale të normës së punësimit të këtyre profesioneve.

Nga ana tjetër, sistemi arsimor në Kosovë nuk është në harmoni me tregun e punës kështu që shumë të rinjë e shohin emigrimin jasht Kosovës si mundësi për shkollim më cilësor dhe më të përshtatshëm për tregun e punës.

Përkundër zvogëlimit të vazhdueshëm të numrit të nxënësve në Kosovë kemi zgjerim të rrjetit të fakulteteve që përgatisin kuadër për mësimdhënie që në realitet paraqet moskoordinim në mes shkollimit dhe tregut të punës, duke shkaktuar kështu problemin kur shumë studentë pas përfundimit të studimeve i bashkangjiten korpusit të pa punëve dhe grupeve potenciale për emigrim. **Në këtë mënyrë mos koordinimi në mes arsimit dhe tregut të punës po kthehet në faktor shtytës për emigrim.** Për të rinjtë, që zakonisht janë pjesa më e lëvizshme e popullsisë, pamundësia për të gjetur një punë është një nga faktorët kryesorë shtytës për emigrim. Papunësia në këtë pjesë të popullsisë është jashtëzakonisht e madhe në Kosovë, ku përafërsisht afër gjysma e të rinjve nuk kanë mundësi të gjejnë punë pas përfundimit të shkollës.

Një studim i realizuar nga Demokraci Plus dhe Westminster Foundation for Democracy tregon se kostoja totale e shkollimit të personave që largohen nga Kosova në një vit, në varësi të strukturës arsimore, varion nga pak më shumë se 180 milionë euro deri në gati 205 milionë euro. Duke qenë se është e pamundur të parandalohet dalja vjetore e popullsisë përmes punësimit, gjenerohet një humbje vjetore e PBB-së potenciale në vlerë prej rreth 519 milionë euro. E thënë thjesht, çdo individ i punësueshëm që emigron nga Kosova merr një mesatare prej pothuajse 17,000 € në vit në GDP potenciale vjetore të ardhshme që do të mund të ishte realizuar nëse flukset ekonomike do të kishin mundësuar punësimin e tyre produktiv³¹.

³¹ How much does youth emigration cost Kosovo? 28.06 2021. E qashme në <https://www.wfd.org/story/how-much-does-youth-emigration-cost-kosovo>

Perspektiva e kontingjenteve të moshave shkollore deri në 2061 - varianti i mesëm

Kontigjenti i numrit të fëmijëve parashkollor 4-6 vjeç³², e cila ndodhet në fazën para shkollore-çerdheve në Kosovë do të karakterizohet me tendencë të zvogëlimit shumë të shpejtë. Kështu, në raport me vitin 2011 në vitin 2061, ky kontingjent do të përgjysmohet.

Tabela 2. Perspektiva e numrit të fëmijëve parashkollor 4-6 vjeç

	Regjistrimi 2011	Projeksionet		Rritje/zvogëlim	
		2031	2061	2031	2061
Kosovë	91,634	73,700	41,810	-19.6	-54.4

Kështu në raport me vitin 2011 në vitin 2061 në Kosovë do të ketë 498 çerdhe më pak.

Kontigjenti i numrit të fëmijëve të shkollimit fillor 7-14 vjeç: Në vitin 2031 do të jetë më i vogël për 83462 ndërsa në vitin 2061 për 163749 nxënës, kështu që edhe pjesëmarrja e këtij kontingjenti do të zvogëlohet nga 15.8% (2011, në 10.2% (2031), si dhe 6.7% (2061). Për pasojë, në shkollat fillore të Kosovës në raport me vitin 2011, në vitin 2031 do të ketë rreth 4173, ndërsa në vitin 2061 rreth 8178 paralele më pak (nëse llogaritet mesatarja 20 nxënës për paralele).

Tabela 3. Perspektiva e numrit të fëmijëve të shkollimit fillor 7-14 vjeç

	Regjistrimi 2011	Projeksionet		Rritje/zvogëlim	
		2031	2061	2031	2061
Kosovë	280,853	197,391	117,104	-29.7	-58.3

Kontigjenti i numrit të fëmijëve të shkollimit të mesëm 15-18 vjeç: Aspak më e mirë nuk do të jetë situata edhe me kontingjentin e shkollimit të mesëm. Në raport me vitin 2011, në vitin 2031 popullsia e kontingjentit të shkollimit të mesëm do të zvogëlohet për 44755, ndërsa në vitin 2061 për 79615 nxënës. Pjesëmarrja do të zvogëlohet nga 8 % (2011), në 5.1% (2031) dhe 3.6% (2061). Kjo do të thotë se Kosova në vitin 2031 do të ketë rreth 1790, ndërsa në vitin 2061 rreth 3184 paralele më pak se sa në vitin 2011 (nëse llogaritet mesatarja 25 nxënës për paralele).

Tabela 4. Perspektiva e numrit të fëmijëve të shkollimit të mesëm 15-18 vjeç

	Regjistrimi 2011	Projeksionet		Rritje/zvogëlim	
		2031	2061	2031	2061
Kosovë	142,428	97,673	62,813	-31.4	-55.9

Reduktimi i kontingjentit të shkollimit do të përcjellët me reduktim të numrit të mësimdhënësve, do të kërkojë planifikim të shkollimit për mësimdhënës- reduktohen kuotat e regjistrimit në drejtimet arsimore dhe mbylljen e shumë shkollave nga i cili proces më të goditura do të jenë zonat rurale, proces ky i pranishëm në shumë vise kodrinore-malore të Kosovës.

³² “Parashikimi i Popullsisë së Kosovës 2011-2061”. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Prishtinë 2013.

Kontigjenti i numrit të rinjve në periudhën fillestare të studimeve 19 vjeç, në Kosovë do të karakterizohet me tendenca të zvogëlimit. Kështu në raport me vitin 2011 ky kontingjent do të zvogëlohet për: 29.1% me 2031 dhe 54% deri me 2061.

Tabela 5. Perspektiva e numrit të rinjve në periudhën fillestare të studimeve 19 vjeç

	Regjistrimi 2011	Projeksionet		Rritje/zvogëlim	
		2031	2061	2031	2061
Kosovë	35519	25198	16336	-29.1	-54.0

Mbështetur në të dhënat e lartë cekura, mund të përfundohet se është reale pritja e problemeve me zvogëlimin e numrit të studentëve në të ardhmen, edhe pse shumë Universitete me këtë problem kane filluar të ballafaqohen tashmë. Sipas të gjithë skenarëve, përfshirë edhe ato më optimistët për zhvillimin demografik, zvogëlimi relativ i popullsisë në moshë shkollare është më i madhi në raport me të gjitha grup moshat tjera të popullsisë³³.

Pasoja për sigurinë e vendit

Në shekullin XXI, koncepti i “sigurisë” është transformuar shumë dhe nuk barazohet vetëm me sigurinë ushtarake, por përfshin edhe lloje të tjera, të tilla si siguria demografike, ekonomike, ekologjike, politike dhe lloje të tjera të sigurisë. Pa siguri veprimtaria e njeriut është joefikase dhe nganjëherë e pakuptimtë. Çështja e emigrimit e popullsisë nuk trajtohet më vetëm si humbje në sferën demografike dhe sociale, por gjithnjë e më tepër po trajtohen edhe në kontekstin e ndikimit në sigurinë lokale dhe atë globale. Viteve të fundit në literaturën demografike gjithnjë e më tepër po gjen përdorim koncepti i “sigurisë demografike” i cili nënkupton rënien e popullsisë dhe lëvizjet negative demografike si çështje të sigurisë se përgjithshme, ku këto lëvizje mund të ndikojnë në sigurinë kombëtare qoftë në aspekt të fuqisë ushtarake, ekonomike etj., në krahasim me grupet e caktuara brenda vendit ose edhe në raport me vendet fqinje, prandaj në këtë kontekst për Kosovën emigrimit janë një nga çështjet më të rëndësishme të sigurisë sot.

Sikur edhe në sferat tjera, njëjtë edhe në sferën e sigurisë, emigrimet e jashtme të popullsisë kanë ndikim më negativ në krahasim me emigrimet e brendshme. Emigrimet posaçërisht ato të jashtme përmes zbrazjes demografike të komunave të pazhvilluara dhe kufitare, zvogëlimi i popullsisë, ndryshimet në strukturën moshore të popullsisë dhe plakja e popullsisë, janë probleme më të mëdha veçanërisht në kombinim me strukturën e pafavorshme arsimore të popullsisë, migrimet e brendshme, shpërnguljet e detyruara dhe spontane të cilat prodhojnë efekte negative në sistemin e mbrojtjes. Prandaj zhvillimi i pabarabartë demografik ndikon në funksionimin e sistemit të mbrojtjes dhe aftësinë për t’iu përgjigjur sfidave, rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë, dhe si i tillë paraqet rrezik për sigurinë e vendit. Nga zhvillimet demografike në dy dekadave të fundit, por edhe nga parashikimet mund të

³³ Behrami S., Bajraktari F (2019). “Sfidat në zhvillimin demografik të Kosovës dhe ndikimi i tyre në sistemin arsimor”. Instituti Pedagogjik I Kosovës.

arrihet në përfundimin se emigrimi i popullsisë ka një ndikim të rëndësishëm në peshën e rënies totale të numrit të popullsisë në Kosovë duke ndikuar kështu negativisht edhe në sigurinë e përgjithshme.

Gjithashtu, ndikim veçanërisht negativ në sigurinë e vendit reflektohet në "ikjen e trurit" dhe ikjen e fuqisë punëtore "të zakonshme", duke zvogluar aftësitë, potencialin dhe fuqinë ekonomike të vendit si bazë themelore të sigurisë së vendit. Efektet negative të migrimit për motive punësimi mund të jenë direkte dhe indirekte. Efektet e drejtpërdrejta, negative reflektohen në reduktimin e konsumit, e rrjedhimisht edhe të TVSH-së së arkëtuar, kontributeve të paguara dhe taksave mbi të ardhura. Efektet indirekte të emigrimit të fuqisë punëtore janë kostot e investimit të shoqërisë në një person nga lindja deri në momentin e largimit nga vendi, ku përfshihen edhe shpenzimet e ushqimit, strehimit dhe shkollimit etj.

Largimi i popullatës me arsim të lartë "ikja e trurit" jashtë vendit sot llogaritet si një nga kërcënimet kur bëhet fjalë për ndikimin e emigrimeve në sigurinë e vendit. Për shkak të gjendjes të rënduar ekonomike të viteve të '80 posaçërisht në vitet e '90, e që fatkeqsisht vazhdon edhe sot, Kosova u godit nga një valë emigrimi i njerëzve me arsim të lartë me potencial dhe aftësi shkencore. Këtë e dëshmon edhe fakti i rritjes së pjesmarrjes të emigrantëve me shkollim të lartë universitar (para emigrimit) nga 17.8% në vitet e '90 të shekullit të kalur në rreth 31.5%³⁴, në dekadën e parë të shek XXI. Ky trend është ende aktual edhe sot me pasoja dhe ndikim negativ të shumëfishta. Fatkeqësisht tani për tani, Kosova nuk ka asnjë mekanizëm ligjor ose strategji për të kufizuar "ikjen e trurit" nga vendi.

³⁴ "Raporti i zhvillimit njerëzorë në Kosovë 2014- Migrimi si force për zhvillim". UNDP. Prishtinë 2014. fq 24

MASAT KUNDËR EMIGRIMIT

Emigrimi masiv nga Kosova tanimë mund të konsiderohen si kërcënues për prosperiteti ekonomik dhe social i shoqërisë kosovare. Progresi teknologjik, rritja ekonomike, progresi social dhe integrimi në BE dhe NATO janë të padobishme nëse nuk ruhet dhe ripërtrihet substanca demografike dhe kohëzisioni social i shoqërisë. Prandaj imperativ për zhvillimin e tashëm dhe të ardhshëm të Kosovës është që emigrimit e popullsisë të jenë të qëndrueshme. Qëndrueshmëria e migrimit nënkupton politika proaktive demografike, ekonomike, sociale, teknologjike dhe rajonale, të cilat do të sigurojnë që Kosova të jetë një vend tërheqës për të jetuar, në radhë të parë për banorët e saj.

Me qëllim të arritjes të qëndrueshmërisë së emigrimeve autoritetet duhet të fokusohen në disa aktivitete që mund të permbledhen në:

- Aktivitetet që përfshijnë reforma për përmirësim e perspektivës ekonomike, politike, sociale etj., të jetës së qytetarëve dhe ekonomisë së Kosovës, të cilat do të krijojnë kushte për reduktimin e emigracionit në fazën e parë, rritjen e kthimit dhe rritjen e transferimit të njohurive, aftësive si dhe investimeve të diasporës në Kosovë në veprimtaritë me interes në radhë të parë për diasporën;
- Aktivitetet e autoriteteve të Kosovës në lidhje me zhvillimin e marrëdhënieve me diaspora përmes strategjive dhe programeve që përfshijnë diasporën në zhvillimi e vendit, krijimin e kushteve për kthime vullnetare, rritjen e dërgesave në Kosovë, transferimi i njohurive dhe aftësive, investimi dhe zhvillimi me një rol aktiv të diasporës duke përfshirë aktivitete të qeverisë së Kosovës dhe partneritetit me agjencitë ndërkombëtare të zhvillimit që veprojnë në Kosovë të cilat si target kanë çështjet e emigrimit (UNDP, IOM, USAID, GIZ, SIDA dhe të tjera);
- Aktiviteti i autoriteteve të Kosovës që për synim kanë zhvillimin e partneritetit me vendet kryesore të imigracionit nga Kosova me qëllim zhvillimin e strategjive dhe programeve për financim të qëndrueshëm të transfereve të njohurive dhe aftësive, edukimi për tregjet vendase dhe të huaja të punës, forcimi i kapaciteteve për qasje në fondet IPA, qasja e Kosovës në fondet e BE-së pas marrjes së statusit kandidat etj.

Problemet demografike duke përfshirë edhe emigrimet me të cilat do të ballafaqohet Kosova gjatë shek. XXI mund të parandalohen ose zbuten përmes politikave populatave. Politikat populatave mund të jenë: ekspansive (pronataliste), kufizuese (anti-nataliste), rishpërndarëse (e ekuilibruar) dhe kualitative ose eugjenike. Për të arritur një nivel të kënaqshëm të riprodhimit të popullsisë, përdoret një politikë e zgjeruar (pronataliste) e popullsisë, e cila nënkupton futjen e masave për të stimuluar rritjen më të shpejtë të popullsisë. Politika kufizuese e popullsisë (anti-nataliste) nënkupton masa që

duhet të parandalojnë ose ngadalësojnë rritjen e mëtejshme të popullsisë. Rishpërndarja, ka tendencë të shkaktojë një shpërndarje më të barabartë të popullatës në lidhje me mjetet e mundshme të jetesës, d.m.th një shpërndarje të barabartë të popullatës në të gjithë territorin e shtetit që më tepër do të kishte ndikim në emigrimet e brendshme. Politika eugjenike e popullsisë kërkon të arrijë një cilësi të caktuar të popullsisë, d.m.th. për të inkurajuar zhvillimin e karakteristikave të caktuara biologjike të popullsisë. Në histori, një politikë e tillë u ndoq në kohën e përhapjes së nacionalizmit, kur u kërkua zhvillimi i një kombi.

Megjithatë, politika të mira populatave nënkupton një sistem masash që ndikojnë në proceset demografike (lëvizja natyrore dhe mekanike e popullsisë) në mënyrë që trendët e popullsisë të jenë në harmonizim me qëllimet ekonomike, sociale, politike dhe të tjera të zhvillimit të vendit.

Meqenëse, emigrimet janë faktori më i rëndësishëm në rënien ose stagnimin e popullsisë të Kosovës, është e nevojshme që shteti të veprojë në mënyrë që të ndikoj në zvogëlimin e shkaqeve që nxisin emigracionin. Kjo mund të arrihet me rritje të përpjekjeve për të zvogëluar pasigurinë ekonomike dhe psikologjike në përputhje me rrethanat, për të përshpejtuar zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, krijimin e një atmosfere prosperiteti, të mbështesin programet shëndetësore dhe arsimore etj. Nëse shkaqet që nxisin popullsinë për emigrim nuk adresohen, masat tjera të orientuara në rritjen e lindshmërisë thjesht mund të rezultojë në më shumë njerëz që largohen nga vendi.

Krijimi i kushteve për njerëzit e sidomos për rininë që të kenë besim në ndërtimin e një të ardhme në vendin e tyre është çelës për ndalimin e krizës demografike në Kosovë.

Nëse popullsia- njerëzit veçanërisht të rinjtë kanë qasje në arsim dhe kujdes shëndetësor, cilësor, nëse janë në punësim të qëndrueshëm dhe marrin mbështetje për rritjen e fëmijëve, ata kanë më pak gjasë të emigrojnë dhe kanë më shumë gjasa të vendosin të kenë fëmijë.

Gjithashtu është e rëndësishme të fokusohet edhe në sistemin e vlerave jo-materiale dhe rëndësinë e identitetit kombëtar dhe kulturor. Pastaj, është e nevojshme të ruhen kontakte me shoqata ose individë jashtë vendit, në mënyrë që të promovohet nevoja për t'u kthyer në vend dhe krijimin e lehtësirave për kthimin në vend. Sidoqoftë, nëse masat nuk janë të shpejta dhe efikase në një të ardhme të afërt vetëm zvogëlimi i emigracionit edhe masat e prezantuara me lart nuk do të jenë të mjaftueshme por është gjithashtu e nevojshme të mendohet për tërheqje të emigrantëve nga vendet tjera i cili si proces përcillet me probleme të shumta.

PËRFUNDIM

Në tri dekadat e fundit Kosova karakterizohet si territor me ulje të shpejtë të lindshmërisë dhe shtimit natyror, normë të lartë të emigrimeve e përcjellë kjo me ndryshime edhe në strukturën e popullsisë sipas moshës të cilat për pasojë kanë shkaktuar perkeqsimin e situatës në shumë segmente të jetës në Kosovë. Kosova sot ndodhet para ndryshimeve radikale në profilin e saj demografik. Këtë më së miri e argumenton fakti se: në njërin anë kemi zvogëlim drastik të numrit të lindjeve dhe shtimit natyror ndërsa në anën tjetër, si pasojë e emigrimeve selektive, popullsia po plakët me trend të përshpejtuar. Situata është aq e pafavorshme sa që mund të përcaktohet edhe si krizë demografike. Problemet demografike me të cilat po ballafaqohet Kosova gjatë dy dekadave të shek. XXI mund të parandalohen ose zbuten përmes politikave popullore të cilat do të mundësonin krijimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshem demografik.

Qëndrueshmëria demografike arrihet me krijimi i kushteve për njerëzit e sidomos për rininë që të kenë besim në ndërtimin e një të ardhme në vendin e tyre që është çelës për ndalimin e krizës demografike në Kosovë. Nëse popullsia veçanërisht të rinjtë kanë qasje në arsim dhe kujdes shëndetësor cilësor, nëse janë në punësim të qëndrueshem dhe marrin mbështetje për rritjen e fëmijëve, ata kanë më pak gjasa të emigrojnë dhe kanë më shumë gjasa të vendosin të kenë fëmijë. Pra qëndrimi në vendlindje, nënkupton eliminimin e shkaqeve të cilat shtojnë të rinjtë për të emigruar, të cilat lidhen me mungesën e stabilitetit, kushtet e papërshtatshme financiare dhe të punës, problemet me papunësinë dhe varfërinë, problemet e vazhdueshme që lidhen me korrupsion, si dhe standardi më i ulët i jetesës dhe cilësinë e jetës e të rinjëve në Kosovë. Kualiteti dhe standarti me një cilësi më të lartë të jetës nënkupton ndryshime jo vetëm në aspektin e zhvillimit ekonomik, por edhe në aspektin e arsimit formal dhe joformal, shërbimeve të kujdesit shëndetësor, burime të sigurta të të ardhurave etj.

Meqenëse, emigrimet janë faktori më i rëndësishëm në rënien ose stagnimin e popullsisë së Kosovës, është e nevojshme që shteti të veprojë në mënyrë që të ndikoj në zvogëlimin e shkaqeve që nxisin emigracionin. Kjo nënkupton që institucionet e Kosovës, krahas zbatimit të ligjshmërisë dhe forcimit të kuadrit rregullator në zhvillimin ekonomik, tregun e punës dhe sistemin e mirëqenies, vëmendjen më shumë duhet ta përqendroj në krijimin e vendeve të reja të punës, nxitjen e punësimit dhe reduktimin e papunësisë dhe të varfërisë. Kjo do të krijonte kushtet për reduktimin e flukseve migratore, nëpërmjet dekurajimit të faktorëve shtytës të emigrimit.

Në këtë kuptim, zhvillimi ekonomik nuk ka asnjë alternativë si parakusht themelor për ndërprerjen e emigrimeve, por edhe zbatimin e politikave pro lindshmërisë, të cilat janë dy procese me rëndësi jetike për të ardhmen e zhvillimeve të përgjithshme në Kosovë.

Perspektiva e zhvillimit të ardhshëm e bën të domosdoshme ndërmarrjen e masave në drejtim të vënies nën kontroll të fenomeneve demografike sidomos të emigrimeve dhe lindshmërisë, pas që **parashikimet e popullsisë së Kosovës tregojnë se edhe në të ardhmen Kosova do të**

balafaqohet me sfida si pasojë e drejtpërdrejtë e zhvillimeve të pa favorshme demografike të cilat në vitet dhe dekadat në vazhdim vetëm sa do të thellohen më teper.

Zhvillimet demografike duke përfshirë edhe emigrimet dhe pasojat e këtyre zhvillimeve si ato të tashme, ashtu edhe ato me të cilat do të përballët shoqëria kosovare në të ardhmen, nuk lejojnë qëndrimin indiferent të shoqërisë dhe shtetit me këto zhvillime por duhet të merren masa të menjëhershme të politikave të popullatave, me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm demografik i cili është kusht për zhvillim të qëndrueshëm të përgjithshëm dhe plotësimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Nëse zhvillimit demografik, si edhe emigrimeve nuk i kushtohet vëmendje e duhur me masa të menjëhershme përmes politikave të mirëfillta popullore, atëherë nga dekada e tretë e shek. XXI, zhvillimit demografik do të shndërrohet në faktor kufizues për zhvillim në të gjitha sferat e jetës në Kosovë. Në këtë drejtim emigrimet janë vetëm një pjesë në grupin e sfidave të përgjithshme me të cilat do të ballafaqohet Kosova në periudhën e ardhshme, **por ndoshta një nga më vendimtare për përmirësimin dhe stabilitetin e ardhshëm social, demografik dhe socio-ekonomik të vendit dhe të popullatës së saj.**

Meqenëse të rinjtë përbëjnë pjesën më të madhe të emigrantëve duke kërkuar mundësinë e tyre në vendet e zhvilluara të BE-së dhe paraqesin grupmoshat më të rëndësishme të zhvillimit të gjitha sferave në Kosovë, atëherë shteti i Kosovës duhet të orientohet në plotësimin e kërkesave të tyre me qëllim për t'i mbajtur të rinjtë në vend sa më shumë që të jetë e mundur apo edhe t'i tërheqë ata nga fluksi emigrues. Për arritjen e këtij qëllimi autoritetet duhet të fokusohen në arsimim, punësimi dhe zgjidhjen e çështjeve të strehimit të të rinjve! Për arritjen e këtyre qëllimeve Kosova duhet të fokusohet edhe në shfrytëzimin e mundësive dhe burimeve të Bashkimit Evropian për t'i mbajtur të rinjtë në vend.

Me qëllim të zgjidhjes dhe zvogëlimit të potencialit migrues të të rinjve, institucionet e Kosovës duhet të ndërmarrin disa masa:

1. Të rinjtë nuk duhet të përjashtohen nga procesi i vendimmarrjes, si për veten e tyre, ashtu edhe për çështje të tjera të jetës sociale dhe ekonomike të Kosovës. Kështu, gjithpërfshirja, do të mundësojë që zëri i tyre të dëgjohet më fuqishëm me çka vendimmarrësit do të jenë të informuar nga dora e parë me shqetësimet dhe problemet e rinisë të cilat mundë të jenë edhe faktorë të cilat nxisin emigracionin e tyre;
2. Në të njëjtën kohë, është thelbësore të zhvillohen modele për inkurajimin e pavarësisë së të rinjve përmes mbështetjes qoftë financiare, qoftë asaj politike por edhe me politika të sferës sociale dhe familjes. Kjo do të krijonte kushte për planifikim dhe siguri më të madhe në krijim të familjes dhe një të ardhme më të sigurt. Edhe me këtë rast projektet dhe mbështetja e ofruar nga Bashkimi Evropian duhet të mbeten opione në përmbushjen e këtyre synimeve;

3. Institucionet duhet të investojnë dhe të avokojë për arsimim me financim publik dhe me cilësi të lartë konform kërkesave të tregut të punës me cka të rinjëve do t'u jepet mundësia të qëndrojnë në Kosovë duke u krijuar kushte më të mira për jetë dhe kushtet më të mira të punës;
4. Meqenëse sistemi arsimor është pjesë e pazëvendësueshme e jetës së çdo të riu, atëherë të rinjtë duhet inkujuar në mundsitë që ofrojnë vendet e Bashkimit Evropian në sferën e arsimit, në fitimin e përvojave dhe të njohin kultura të tjera. Institucionet vendore duhet angazhohen me investime përmes bursave më të mëdha dhe më të shumta në mënyrë që të rinjtë të fitojnë më lehtë njohuri dhe përvojë të re në ndërveprim me kolegët e universiteteve të tjera;
5. Studime të shumta tregojnë se të rinjtë kanë mungesë të përvojës së punës, zbatimi praktik të njohurive, valorizimi i pamjaftueshëm i njohurive të marra përmes arsimimit etj., që janë arsyt të disavantazhit për të rinjtë kur kërkojnë punë, prandaj institucionet përgjegjëse duhet të ndërmarrin hapa të menjëhershëm me qëllim të ndryshimit të kësaj gjendje përmes mbështetjes më të madhe të rinjve në përvetësimin e njohurive dhe aftësive përmes trajnimit, edukimit dhe shkëmbimit të njohurive dhe përvojës;
6. Institucionet vendore duhet të investojnë në pavarësimin e mëhershëm të të rinjëve, meqenëse në Kosovë të rinjtë bëhen të pavarur shumë më vonë se moshatarët e tyre në vendet më të përparuara të Bashkimit Evropian. Përparimi i ngadaltë në karrierë dhe puna e pasigurtë janë arsyt themelore të pavarësimin të të rinjëve në Republikën e Kosovës. Me qëllim të përmirimit të gjendjes është e nevojshme vlerësimi dhe avancimi i tyre në përputhje me përpjekjet dhe punën e tyre e cila arrihet me ndërgjegjësimin e punëdhënësve dhe të gjithë shoqërisë për rëndësinë e sigurisë së punës për të rinjtë.

Këto janë vetem disa nga masat të cilat do të ndikonin në uljen e potencialit migrues të të rinjëve nga Kosova. Ekzistojnë edhe shumë aktivitete të cilat me investime minimale do të kishin ndikim të konsiderueshem në uljen e aspirateve të të rinjëve për emigrim drejt krijimit të qëndrueshmërisë të emigrimeve në përgjithësi dhe emigrimeve të të rinjëve në veçanti.

REKOMANDIME

Duke pasur parasysh faktin se bilanci i migracionit të jashtëm është negativ dhe se parashikimet tregojnë se emigracioni do të vazhdojë, synimi strategjik në këtë fushë duhet të jetë ngadalësimi i trendit të rritjes së emigracionit, ndalimi i një tendence të tillë dhe pakësimi i emigrimit jashtë vendit. Me qëllim që emigrimi nga Kosova të shndërrohet në proces të qëndrueshëm duhet të ndermirren këto masa:

1. Agjencia e Statistikave brenda një viti të ndërtoj një sistem të ndarë, të veçantë të mbledhjes, analizimit dhe hapjes së të dhënave për numrin, strukturën e migrantëve, llojet e migrimit, arsyet dhe faktorët e tij. Këto sete të të dhënave, duhet të përditësohen në baza mujore, të segregohen në bazë të komunave dhe të shpërndahen në të gjitha institucionet publike.
2. Qeveria e Kosovës duhet të miratoj një Program Kombëtar për Promovimin e Investimit të Diasporës. Ky program duhet të përfshij një qasje të qartë strategjike në fushën e migrimit me qëllim të përfitimit ekonomik të vendit.
3. Migrimi të përfshihet si faktor analizues gjatë përgatitjes së kornizës strategjike dhe legjislative të vendit. Krahas kostos financiare, analizës së ndërlidhjes me legjislacionin evropian dhe mbrojtjes së mjedisit, analiza e migrimit duhet t'i bashkangjitet secilës nismë legjislative.
4. Kosova të themeloj një sistem online, ose t'a integroj në kuadër të platformës e-kosova, ashtu që të ndërlidh kërkesat e bizneseve për fuqi punëtore me zyret e punësimit. Ky sistem do të mundësonte që në mënyrë automatike, shkollat profesionale të zhvillojnë programe të trajnimit ad-hoc në mënyrë që të mundësohet plotësimi i vendeve të kërkuara të punës në kohë reale. Ky sistem duhet të ndërlidhet me skema të subvencionimit fillestar dhe instrumente të tjera për lehtësimin e këtij komunikimi.
5. Ministria e Zhvillimit Rajonal duhet të ndërlidh projektet zhvillimore për rajonet e Kosovës bazuar në të dhënat mbi komunat dhe rajonet me numrin më të madh të emigrantëve. Instrumentet financiare për zhvillimin e ndërmarrësisë, investimet infrastrukturore dhe subvencionet duhet të fokusohen në zonat ku nevoja për parandalim të emigrimit është më e madhe.

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
<i>Deçan</i>	-47	-124	-405	-188	-243	-161	-68	-75	-95	-25	-265
<i>Gjakovë</i>	-185	-269	-965	-1666	-2146	-218	-787	-1294	-1735	124	-2097
<i>Gllgoc</i>	-187	-266	-697	-727	-771	-351	-185	-858	-1047	-67	-1218
<i>Gjilan</i>	-146	-240	-880	-5185	-7782	-1613	-565	-2361	-3111	446	-4112
<i>Dragash</i>	-116	-188	-411	-418	-438	-112	-95	-301	-412	-33	-552
<i>Istog</i>	29	27	-262	-635	-906	-65	109	25	-38	32	-278
<i>Kaçanik</i>	-123	-178	-418	-503	-546	-162	-106	-168	-207	-80	-321
<i>Klinë</i>	-69	-102	-388	-780	-1051	-143	-88	-385	-538	10	-738
<i>Fushë Kosovë</i>	456	637	329	-645	-1217	268	132	-310	-682	580	-1175
<i>Kamenicë</i>	-303	-395	-670	-1872	-2512	-559	-273	-1411	-1723	70	-1851
<i>Mitrovicë</i>	-173	-248	-760	-2858	-4197	-815	-19	-869	-1116	2	-1628
<i>Mitr. e Veriut</i>	0	-23	-111	22	39	-2	6	-49	-74	4	-105
<i>Leposaviq</i>	-23	-34	-132	25	30	-8	-8	-147	-220	46	-293
<i>Lipjan</i>	-100	-183	-577	-1726	-2474	-319	-82	-651	-834	4	-1144
<i>Novobërdë</i>	52	74	18	11	-10	70	80	-27	-54	29	-87
<i>Obiliq</i>	-29	-43	-204	-1362	-2120	-446	-118	-751	-948	56	-1155
<i>Rahovec</i>	-138	-215	-614	-265	-68	-235	-902	-1711	-2128	162	-2184
<i>Pejë</i>	-121	-186	-897	-1062	-1264	-76	-117	-1199	-1560	63	-1802
<i>Podujevë</i>	-637	-937	-1517	-3318	-4485	-1261	-778	-1620	-2022	-282	-2496
<i>Prishtinë</i>	590	809	-753	-3314	-4833	395	1473	444	47	369	-1306
<i>Prizren</i>	1	-46	-1361	-382	126	-62	297	-751	-1208	231	-2075
<i>Skenderaj</i>	-321	-461	-814	-668	-583	-372	-368	-498	-581	-191	-691
<i>Shtime</i>	-48	-66	-273	-673	-943	-139	-210	-443	-631	112	-825
<i>Shtërpçë</i>	-35	-40	-99	-42	-27	-55	-20	-30	-40	-9	-77
<i>Suharekë</i>	-124	-183	-624	-1552	-2125	-319	-934	-1970	-2446	320	-2512
<i>Ferizaj</i>	14	-65	-815	-5302	-8241	-1410	450	3	-287	172	-1715
<i>Viti</i>	-118	-179	-514	-958	-1265	-168	-143	-462	-616	-15	-817
<i>Vushtrri</i>	-175	-281	-765	-3368	-5018	-501	-1293	-1656	-2097	291	-2459
<i>Zubin Potok</i>	-11	-17	-64	9	-1	-5	-3	-19	-27	0	-45
<i>Zveçan</i>	-15	-23	-75	13	-1	-5	-1	-17	-26	-1	-43
<i>Malishevë</i>	-174	-291	-654	-652	-650	-162	-796	-1725	-2200	325	-2276
<i>Junik</i>	8	7	-36	35	4	12	-112	-22	-34	10	-45
<i>Mamushë</i>	-5	-9	-49	13	8	-2	1	-109	-138	7	-139
<i>Hani i Elezit</i>	-9	-14	-83	9	-47	-10	-11	-39	-50	-2	-60
<i>Graçanicë</i>	200	306	181	306	155	66	85	58	47	52	9
<i>Ranillug</i>	-1	-1	-30	13	8	1	4	0	-3	2	-8
<i>Partesh</i>	-1	-1	-14	6	5	0	2	-4	-6	2	-8
<i>Kllokot</i>	31	46	22	50	17	4	12	0	-5	5	-13
<i>Gjithsej</i>	-2081	-3402	-16381	-39609	-55572	-8940	-5431	-21402	-28845	2821	-38606

Tabela 6. Bilanci i përgjithshëm i migrimeve në komunat e Kosovës 2011-2021

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
<i>Deçan</i>	-47	-95	-366	-149	-206	-119	-24	-33	-51	4	-230
<i>Gjakovë</i>	-111	-195	-867	-1567	-2052	-120	-687	-1198	-1637	190	-2018
<i>Gllugoc</i>	-68	-147	-539	-567	-619	-191	-22	-695	-881	45	-1084
<i>Gjilan</i>	-105	-199	-825	-5129	-7729	-1564	-511	-2278	-3027	503	-4044
<i>Dragash</i>	-40	-112	-310	-316	-341	-29	-12	-219	-328	23	-484
<i>Istog</i>	-46	-48	-362	-737	-1002	-90	83	-5	-69	11	-303
<i>Kaçanik</i>	-39	-94	-306	-390	-439	-50	7	-59	-96	-5	-231
<i>Klinë</i>	-45	-78	-356	-747	-1020	-105	-49	-352	-504	33	-711
<i>Fushë Kosovë</i>	-41	140	-333	-1317	-1864	-365	-501	-1039	-1424	78	-1773
<i>Kamenicë</i>	-42	-97	-322	-1522	-2180	-404	-116	-1256	-1566	177	-1724
<i>Mitrovicë</i>	-98	-173	-660	-2756	-4100	-720	75	-787	-1033	58	-1561
<i>Mit. e Veriut</i>	0	0	-111	21	38	-5	3	-47	-72	5	-104
<i>Leposaviq</i>	-16	-27	-123	31	36	-10	-9	-149	-222	45	-295
<i>Lipjan</i>	-67	-150	-532	-1681	-2431	-286	-48	-547	-728	76	-1059
<i>Novobërdë</i>	-8	14	-62	-70	-80	-4	6	-61	-88	6	-114
<i>Obiliq</i>	-25	-39	-199	-1358	-2116	-436	-109	-727	-924	73	-1136
<i>Rahovec</i>	-66	-143	-518	-168	24	-138	-804	-1609	-2024	232	-2100
<i>Pejë</i>	-113	-178	-886	-1051	-1253	-55	-98	-1168	-1528	84	-1776
<i>Podujevë</i>	-103	-403	-805	-2596	-3800	-586	-105	-972	-1362	164	-1964
<i>Prishtinë</i>	-233	-14	-1851	-4427	-5988	-679	399	-592	-1007	-345	-2155
<i>Prizren</i>	-208	-255	-1640	-662	-139	-341	15	-1032	-1494	37	-2305
<i>Skenderaj</i>	-59	-199	-465	-314	-248	-39	-38	-196	-273	17	-444
<i>Shtime</i>	-32	-50	-252	-651	-922	-120	-194	-439	-627	115	-822
<i>Shtërpçë</i>	-8	-13	-63	-6	7	-34	4	-14	-24	2	-64
<i>Suharekë</i>	-70	-129	-552	-1480	-2111	-251	-866	-1902	-2377	367	-2457
<i>Ferizaj</i>	-127	-206	-1003	-5492	-8436	-1580	275	-168	-462	54	-1855
<i>Viti</i>	-55	-116	-430	-873	-1185	-100	-77	-391	-544	34	-759
<i>Vushtrri</i>	-82	-188	-641	-3242	-4898	-425	-1216	-1590	-2030	336	-2405
<i>Zubin Potok</i>	-8	-14	-59	13	3	-4	-2	-18	-26	1	-44
<i>Zveçan</i>	-9	-17	-67	18	4	-2	2	-14	-23	1	-41
<i>Malishevë</i>	-64	-181	-507	-500	-524	-72	-704	-1643	-2116	381	-2208
<i>Junik</i>	-7	-8	-56	16	2	-2	-125	-31	-44	4	-53
<i>Mamushë</i>	-6	-10	-51	12	7	-3	1	-109	-138	7	-140
<i>Hani i Elezit</i>	-11	-16	-86	7	-51	-4	-3	-33	-44	2	-55
<i>Graçanicë</i>	-12	94	-101	23	31	-2	12	-15	-28	2	-51
<i>Ranillug</i>	-5	-5	-35	9	4	-1	1	-3	-6	0	-10
<i>Partesh</i>	-2	-2	-16	4	3	-1	1	-5	-7	1	-9
<i>Kllokot</i>	-3	12	-24	5	3	-3	5	-6	-11	1	-18
<i>Gjithsej</i>	-2081	-3341	-16381	-39609	-55572	-8940	-5431	-21402	-28845	2819	-38606

Tabela 7. Bilanci i migrimeve të jashtme në komunat e Kosovës 2011-2021

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
<i>Deçan</i>	0	-29	-39	-39	-37	-42	-44	-42	-44	-29	-35
<i>Gjakovë</i>	-74	-74	-98	-99	-94	-98	-100	-96	-98	-66	-79
<i>Glogoc</i>	-119	-119	-158	-160	-152	-160	-163	-163	-166	-112	-134
<i>Gjilan</i>	-41	-41	-55	-56	-53	-49	-54	-83	-84	-57	-68
<i>Dragash</i>	-76	-76	-101	-102	-97	-83	-83	-82	-84	-57	-68
<i>Istog</i>	75	75	100	102	96	25	26	30	31	21	25
<i>Kaçanik</i>	-84	-84	-112	-113	-107	-112	-113	-109	-111	-75	-90
<i>Klinë</i>	-24	-24	-32	-33	-31	-38	-39	-33	-34	-22	-27
<i>Fushë Kosovë</i>	497	497	662	672	647	633	633	729	742	502	598
<i>Kamenicë</i>	-261	-261	-348	-350	-332	-155	-157	-155	-157	-107	-127
<i>Mitrovicë</i>	-75	-75	-100	-102	-97	-95	-94	-82	-83	-56	-67
<i>Mitr. e Veriut</i>	0	-23	0	1	1	3	3	-2	-2	-1	-1
<i>Leposaviq</i>	-7	-7	-9	-6	-6	2	1	2	2	1	2
<i>Lipjan</i>	-33	-33	-45	-45	-43	-33	-34	-104	-106	-72	-85
<i>Novobërdë</i>	60	60	80	81	70	74	74	34	34	23	27
<i>Obiliq</i>	-4	-4	-5	-4	-4	-10	-9	-24	-24	-17	-19
<i>Rahovec</i>	-72	-72	-96	-97	-92	-97	-98	-102	-104	-70	-84
<i>Pejë</i>	-8	-8	-11	-11	-11	-21	-19	-31	-32	-21	-26
<i>Podujevë</i>	-534	-534	-712	-722	-685	-675	-673	-648	-660	-447	-532
<i>Prishtinë</i>	823	823	1098	1113	1155	1074	1074	1036	1054	713	849
<i>Prizren</i>	209	209	279	280	265	279	282	281	286	194	230
<i>Skenderaj</i>	-262	-262	-349	-354	-335	-333	-330	-302	-308	-208	-247
<i>Shëtitë</i>	-16	-16	-21	-22	-21	-19	-16	-4	-4	-4	-3
<i>Shtërpçë</i>	-27	-27	-36	-36	-34	-21	-24	-16	-16	-11	-13
<i>Suharekë</i>	-54	-54	-72	-72	-14	-68	-68	-68	-69	-46	-55
<i>Ferizaj</i>	141	141	188	190	195	170	175	171	175	118	140
<i>Viti</i>	-63	-63	-84	-85	-80	-68	-66	-71	-72	-49	-58
<i>Vushtrri</i>	-93	-93	-124	-126	-120	-76	-77	-66	-67	-46	-54
<i>Zubin Potok</i>	-3	-3	-5	-4	-4	-1	-1	-1	-1	-1	-1
<i>Zveçan</i>	-6	-6	-8	-5	-5	-3	-3	-3	-3	-2	-2
<i>Malishevë</i>	-110	-110	-147	-152	-126	-90	-92	-82	-84	-56	-68
<i>Junik</i>	15	15	20	19	2	14	13	9	10	6	8
<i>Mamushë</i>	1	1	2	1	1	1	0	0	0	0	1
<i>Hani i Elezit</i>	2	2	3	2	4	-6	-8	-6	-6	-4	-5
<i>Graçanicë</i>	212	212	282	283	124	68	73	73	75	51	60
<i>Ranillug</i>	4	4	5	4	4	2	3	3	3	2	2
<i>Partesh</i>	1	1	2	2	2	1	1	1	1	1	1
<i>Klllokot</i>	34	34	46	45	14	7	7	6	6	4	5

Tabela 8. Bilanci i migrimeve të brendshme në komunat e Kosovës 2011-2021



Tetor, 2023